



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit

Sistemet e Informacionit në Doganën e Kosovës - ASYCUDA World



Prishtinë, dhjetor 2024

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji^[1] i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000²) dhe Udhëzuesin për Auditimin e Sistemeve të Informacionit (GUID 5100³).

Auditimet e teknologjisë së informacionit të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë një ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe kontrolleve përkatëse për të fituar siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit⁴, ekonomisë⁵, dhe efektivitetit⁶ të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe kontrolleve përkatëse.

-
- 1 Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës
 - 2 SNISA 3000 – Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike
 - 3 GUID 5100 – Udhëzuesi për auditimin e sistemeve të informacionit lëshuar nga INTOSAI
 - 4 Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës
 - 5 Ekonomia – Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë
 - 6 Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritura.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit “Sistemet e Informacionit në Doganën e Kosovës - ASYCUDA World” në konsultim me Ndhmës Auditoren e Përgjithshme Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Samir Zymberi, Drejtor i departamentit të auditimit;

Poliksena Berisha, Udhëheqëse e ekipit;

Gazmend Lushtaku, Anëtar i ekipit;

Besim Lezi, Anëtar i ekipit; dhe

Naim Neziri, Anëtar i ekipit.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa:Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjja Arbëria,
Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011
<http://zka-rks.org>

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave	7
Përmbledhje e përgjithshme	9
1. Hyrje	13
2. Objektivi dhe fushat e auditimit	17
3. Gjetjet e auditimit.....	21
3.1.Politikat e kontraktimit	23
3.2.Siguria e Informacionit.....	25
3.3.Plani i Vazhdimësisë së Biznesit – Plani i Rikthimit nga Fatkeqësia.....	31
3.4.Kontrollet e aplikacionit.....	34
4. Konkluzionet	43
5. Rekomandimet.....	47
Shtojca I. Dizajni i auditimit	51
1.1.Përshkrimi i sistemit	53
1.1.1.Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	53
1.1.2.Dogana e Kosovës.....	54
Shtojca 2: Letër konfirmimi	70

Lista e shkurtesave

APIS	Sistemi i Avancuar i Informacionit të Pasagjerëve (Advanced Passenger Information System)
ATA	Pranim i Përkohshëm (Admission Temporaire -Temporary Admission)
AW	Sistemi Doganor (ASYCUDA World)
BE	Bashkimi Evropian
CAAT	Teknikat e auditimit me ndihmën e kompjuterit (Computer assisted audit techniques)
CAFAO	Zyra për Asistencë Fiskale (Customs and Fiscal Assistance Office)
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore (Central European Free Trade Agreement)
DATOP	Departamenti i Akcizës, Tarifës, Origjinës dhe Procedurave
DK	Dogana e Kosovës
DOK	Drejtoria Operative dhe e Kufirit
DPI	e Drejta e Pronësisë Intelektuale
DSD	Departamenti për Sisteme Doganore
DShP	Drejtoria e Shërbimeve të Përbashkëta
DUD	Dokumenti Unifikues Doganor
DZL	Drejtoria e Zbatimit të Ligjit
ECM	Sistemi për Menaxhimin e Përmbajtjes (Enterprise Content Management)
EDI	Shkëmbimi Elektronik i të Dhënave (Electronic Data Interchange)
IATA	Organizata Ndërkombëtare e Transportit Ajror (International Air Transport Association)
ICAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (International Civil Aviation Organisation)
ICIS	Sistemi i Integruar i Informacionit Doganor (Integrated Customs Information System)
INES	Softueri për të Drejtat Intelektuale (Software for Intellectual Rights)
KE	Komisioni Evropian
LES	Sistemi i Zbatimit të Ligjit (Law Enforcement System)
MAP	Ministria e Administratës Publike
ME	Ministria e Ekonomisë
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transferve

MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OEA	Operatorët Ekonomik të Autorizuar
PKI	Infrastruktura e Çelësit Publik (Public Key Infrastructure)
PRF	Plani i Rikthimit nga Fatkeqësia
PVB	Plani i Vazhdimësisë së Biznesit
RAS	AW Menaxhimi i Rrezikut dhe Përzgjedhja (AW Risk- Management & Selectivity)
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
SAW	Sektori i ASYCUDA World
SEED	Shkëmbimi sistematik i të dhënave elektronike (Systematic Electronic Exchange of Data)
SPA	Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve
SPTIK	Sektori i Përkrahjes së Teknologjisë Informativë
SRM	Sektori për Risk dhe Monitorim
TARIK	Tarifa e Integruar e Kosovës
TIR	Transporti Rrugor Ndërkombëtar (Transports Internationaux Routiers)
TVSh	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNCTAD	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (UN Trade and Development)
WCO	Organizata Botërore e Doganave (WCO World Customs Organisation)
XML	Gjuhë shenjësuese e zgjeruar (Extensible Markup Language)

Përmbledhje e përgjithshme

Dogana e Kosovës është agjencion për menaxhimin e të hyrave në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Të hyrat e mbledhura nga Dogana kontribuojnë rreth 60% të hyrave të gjithmbarshme që grumbullohen për buxhetin e Republikës së Kosovës. Dogana e Kosovës ka një mision të gjerë, duke filluar nga mbrojtja e shtetit, ekonomisë dhe qytetarëve.

Për realizimin më efikas të misionit të saj Dogana e Kosovës ka digjitalizuar proceset e veta duke zhvilluar dhe vënë në zbatim sistemet e informacionit. ASYCUDA World është sistemi bazë i Doganës së Kosovës, i cili shtrihet në zyrat doganore, porta, pika kufitare dhe zona të lira. Roli kryesor i këtij sistemi është menaxhimi i procedurave doganore për zhdoganimin e mallrave si dhe të menaxhoj të gjitha llojet e të hyrave buxhetore, respektivisht rreth 1.5 miliardë eurove në vit që aktualisht mblidhen nga Dogana e Kosovës.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e Teknologjisë së Informacionit për të vlerësuar nëse sistemi ASYCUDA World i mundëson Doganës së Kosovës të zbatoj proceset elektronike doganore në mënyrë të saktë, të sigurt dhe të besueshme.

Dogana e Kosovës në vazhdimësi ka bërë zhvillime në sistemin ASYCUDA World për të siguruar digjitalizimin e proceseve doganore dhe për të përmirësuar sigurinë dhe saktësinë e të dhënave dhe proceseve që realizohen përmes këtij sistemi dhe sigurinë e vetë sistemit. Gjithashtu, ka zbatuar marrëveshjen për sistemin ASYCUDA, lidhur me promovimin e barazisë gjinore.

Dogana e Kosovës ka mangësi në politikat e kontraktimit, pasi që nuk kanë adresuar mbrojtjen e sigurisë së informacionit në marrëveshjet-kontratat që kanë me palët e jashtme, prandaj në rast të incidenteve të sigurisë kibernetike përgjegjësia e palëve në projektin për sistemin ASYCUDA është e pa përcaktuar.

Kontrollet që zbatohen për mbrojtjen e sigurisë së informacionit në Doganën e Kosovës nuk garantojnë mjaftueshëm integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e sistemit, pasi që politikat e sigurisë së informacionit i kanë të pa përditësuara, kanë mangësi në organizimin e strukturës së stafit, koncentrim dhe konflikt të përgjegjësive lidhur me sigurinë e informacionit dhe mangësi në menaxhimin e qasjeve në sistemet e informacionit. Si dhe mungesë e trajnimeve për ndërgjegjësimin e stafit lidhur me sigurinë e informacionit.

Dogana nuk ka siguruar mekanizma të mjaftueshëm për vazhdimësinë e biznesit, ka mungesë të planit dhe strukturës për funksionalizimin e planit, si dhe procedurave të shkruara për vazhdimësinë e biznesit. Në mungesë të këtyre mekanizmave është rrezikuar vazhdimësia e biznesit në rast të ndonjë fatkeqësie, humbjes, dëmtimit të të dhënave dhe sistemit, si dhe largimit të stafit kyç nga puna.

Kontrollet e aplikacionit që zbatohen në ASYCUDA nuk sigurojnë që vetëm të dhëna të sakta dhe të vlefshme vendosen dhe azhurnohen në sistem. Pasi që disa procese ende realizohen në formë manuale, siç është kalkulimi i koeficientit për përcaktimin e çmimit pas ri-vlerësimit; vlerësimi i rrezikut përmes kriterëve që janë të vendosura vetëm në formë tekstuale, pa lënë mundësi matje. Nuk bën validimin e fushave për regjistrimin e numrit personal/të biznesit dhe markës tregtare në mungesë të ndërlidhjeve me sistemet tjera. Si dhe dizajni për disa nga modulet për përdoruesit e sektorëve për vlerësimin e rrezikut dhe tarifave nuk është i thjeshtë dhe i përshtatshëm për përdoruesin.

Prandaj, rreziqet e identifikuar në politikat e kontraktimit, sigurinë e informacionit, vazhdimësinë e biznesit dhe në kontrollet e aplikacionit, tregojnë që Dogana e Kosovës e cila administron dhe përdor Sistemin ASYCUDA ka nevojë për përmirësime në mënyrë që të dhënat në këtë sistem të jenë të mbrojtura dhe proceset e digjitalizuara doganore të mos ndërprehen. Lidhur me këtë, kemi dhënë 13 rekomandime për Doganën e Kosovës. Lista e rekomandimeve, është paraqitur në Kapitullin 5 të këtij raporti.

Përgjigja e entitetit

Dogana e Kosovës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe është zotuar se do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

HYPER

10

1. Hyrje

Dogana e Kosovës (DK) është zhvilluar në bazë të standardeve të BE-së dhe financohet nga Buxheti i Kosovës, është kontribues kryesor në aspektin e mbledhjes së të hyrave dhe mbrojtjes së qytetarëve të saj nga mallrat e ndaluara dhe të kufizuara.

Sistemi i informacionit i zhvilluar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (UNCTAD), ASYCUDA World është sistemi bazë i Doganës së Kosovës, i krijuar në Gusht të vitit 2011 dhe i vënë në funksion në Shtator 2012.

Ky është programi më i madh për bashkëpunim teknik i UNCTAD-së që mbulon 102 vende të botës, përfshirë Kosovën, Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Shqipërinë në regionin tonë. Kostoja e përgjithshme vetëm për zbatimin (implementimin) e sistemit ASYCUDA është 1,350,158 dollarë amerikan, pa përfshirë pajisjet dhe infrastrukturën. Sistemi shtrihet në

zyrat doganore, porta, pika kufitare dhe zona të lira.

Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganore - ASYCUDA World (AW) është një sistem i kompjuterizuar i menaxhimit doganor që mbulon shumicën e procedurave të tregtisë së jashtme. AW trajton manifestet⁷ dhe deklaratat doganore, së bashku me procedurat e kontabilitetit, transitit dhe pezullimeve doganore. AW bën gjenerimin e të dhënave tregtare që mund të përdoren për analiza statistikore ekonomike. ASYCUDA përdor kodet dhe standardet ndërkombëtare të zhvilluara nga ISO (Organizata Ndërkombëtare për Standardizim), WCO (Organizata Botërore e Doganave) dhe Kombet e Bashkuara. ASYCUDA ofron shkëmbim elektronik të të dhënave (EDI) ndërmjet tregtarëve dhe doganave duke përdorur standardet mbizotëruese, si XML. Në Doganën e Kosovës kjo platformë është në funksion nga viti 2012 me të gjitha modulet e saj dhe që nga ajo kohë e deri në vitin 2023 përmes këtij sistemi

⁷ Manifesti doganor është një dokument zyrtar që përdoret në procedurat doganore për të përshkruar ngarkesën e mallrave që transportohen nga një vend në një tjetër. Ky dokument përmban informacion të detajuar rreth mallrave, përfshirë llojin, sasinë, vlerën, origjinën dhe destinacionin e tyre.

DK-ja ka arritur t'i arkëtoj mbi 11 Miliardë Euro⁸, duke përfshirë konfirmimet automatike në kohë reale, e cila nga 45 minuta sa ka qenë në vitin 2011, tani realizohet për 3 sekonda.

Më poshtë janë përmbledhur aspektet më të rëndësishme të këtij sistemi të cilat janë:

Figura 1. Aspektet më të rëndësishme të sistemit AW



8 Dokument i brendshëm i DK-së me të dhëna nga sistemet doganore - Kërkesë për miratim të sistemeve doganore si sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike.

Funksionet kryesore të sistemit të integruar të menaxhimit Doganor AW, përmes të cilave zhvillohen proceset doganore, e që janë mbuluar gjatë auditimit janë:

Figura 2. Funksionet kryesore të ASYDUCA World



2. Objektivi dhe fushat e auditimit

Objektiv i këtij auditimi është të vlerësohet nëse sistemi ASYCUDA World i mundëson Doganës së Kosovës të zbatoj proceset elektronike doganore në mënyrë të saktë, të sigurt dhe të besueshme.

Me këtë auditim synojmë që të ofrojmë rekomandime relevante për Doganën e Kosovës, në mënyrë që të përmirësoj sistemin e informacionit lidhur me sigurinë e informacionit dhe kontrollet e aplikacionit.

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit, jemi fokusuar në fushën e sigurisë së informacionit dhe kontrollet e aplikacionit, si dhe çështje që lidhen me politikat e kontraktimit dhe vazhdimësisë së biznesit duke i përzgjedhur fushat e auditimit si në vijim:

Tabela 2: Fushat dhe çështjet e auditimit

Fushat e auditimit	Çështjet e auditimit
1. Kontraktimi	1. Politikat e Kontraktimit
2. Siguria e Informacionit dhe Siguria Kibernetike	2. Siguria
	3. Politikat e sigurisë së informacionit
	4. Struktura e sigurisë së TI-së
	5. Siguria e TI-së e Burimeve Njerëzore
3. Plani i Vazhdimësisë së Biznesit	6. Kontrollat e Qasjes
	7. Struktura e funksionit të Vazhdimësisë së Biznesit
4. Plani i Rikthimit nga Fatkeqësia ⁹	
5. Kontrollat e Aplikacionit	8. Kontrollat e hyrjes
	9. Kontrollat e përpunimit

Fushëveprimi i këtij auditimi është Dogana e Kosovës dhe departamentet përkatëse për menaxhimin e TI-së, sistemi ASYCUDA dhe funksionet doganore. Auditimi mbulon periudhën nga viti 2022 deri në vitin 2024.

9 PVB & PRF – Plani për Vazhdimësinë e Biznesit & Plani për Rikthimin nga Fatkeqësia

GEHEIM
DOKUMENT

03

3. Gjetjet e auditimit

Sistemi Asycuda World i zhvilluar nga UNCTAD dhe i përdorur nga Dogana e Kosovës, përfaqëson një inovacion të rëndësishëm në fushën e administratës doganore, duke modernizuar procedurat dhe menaxhimin doganor në një mënyrë më efikase dhe të qëndrueshme. Ky sistem është i projektuar për të thjeshtuar dhe optimizuar proceset që lidhen me tregtinë e jashtme, duke përfshirë deklaratat doganore, operacionet e transitit dhe kontabilitetin e ngarkesave. Përmes këtij sistemi ruhen dhe menaxhohen të dhënat dhe ekzekutohen proceset që kanë të bëjnë me një vlerë rreth 60% e të ardhurave shtetërore të cilat arkëtohen nëpërmjet procedurave të dixhitalizuara të ofruara nga AW.

Një nga përfitimet kryesore të këtij sistemi është përdorimi i standardeve ndërkombëtare, të cilat rrisin nivelin e harmonizimit dhe të bashkëpunimit midis shteteve dhe institucioneve ndërkombëtare. Sistemi gjithashtu mbështet shkëmbimin elektronik të të dhënave (EDI) me DK, duke mundësuar një rrjedhë të pandërprerë informacioni ndërmjet palëve të përfshira. Kjo rrit saktësinë e të dhënave dhe eliminon


nevojën për dokumente fizike, duke kontribuar në një proces më të pastër dhe më miqësor me mjedisin.

Për më tepër, AW është projektuar për të dixhitalizuar dhe optimizuar proceset, gjë që ndikon drejtpërdrejt në uljen e kohës dhe kostove të lidhura me tregtinë ndërkombëtare. Kjo lehtëson tregtinë dhe rrit besimin e bizneseve dhe partnerëve tregtarë në efikasitetin e institucioneve doganore.

Në përfundim, implementimi i sistemit AW përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të tregtisë globale dhe fuqizimit të ekonomive lokale përkatësisht në qëndrueshmërinë financiare dhe administrative.

Megjithatë, krahas zhvillimit të këtij sistemi ka edhe mangësi të cilat janë të paraqitura në këtë kapitull. Gjetjet e auditimit ndërlidhen me politikat e kontraktimit dhe aktivitetet e palëve përgjegjëse për administrimin, sigurinë e informacionit dhe planin për vazhdimësinë e biznesit dhe kontrollet e aplikacionit të Sistemit ASYCUDA World në DK. Gjetjet janë të strukturuar sipas fushave dhe çështjeve të auditimit.

Figura 3. Struktura e çështjeve të auditimit në DK



Pjesa e parë e paraqitur në kapitullin 3.1 mbulon çështjet e identifikuara e që kanë nevojë për përmirësim që lidhen me kontraktimin e sistemeve të informacionit (1).

Pjesa e dytë që është paraqitur në kapitullin 3.2 mbulon çështjet e identifikuara që lidhen me informacionin dhe sigurinë kibernetike (2-5).

Pjesa e tretë që është paraqitur në kapitullin 3.3 mbulon çështjet e identifikuara që lidhen me planin e vazhdimësisë së biznesit dhe planin e rikthimit nga fatkeqësia (6).

Pjesa e katër që është paraqitur në kapitullin 3.4 mbulon çështjet e identifikuara që lidhen me kontrollet e aplikacionit (7-11).

3.1. Politikat e kontraktimit

Organizatat duhet të kenë disa politika të cilat përcaktojnë se cilat funksione mund të kontraktohen dhe cilat funksione duhet të zhvillohen në ambientet e organizatës. Kontraktimi i shërbimeve në organizatë kërkon monitorim të afërt dhe është subjekt i kërkesave të privatësisë dhe sigurisë. Proceset kontraktuale, DK i zhvillon sipas legjislacionit në fuqi, mirëpo ka mangësi në përfshirjen e sigurisë së informacionit gjatë kontraktimit.

Figura 4. Politikat e kontraktimit (Sistemi, politikat dhe siguria e informacionit)



1. Dogana e Kosovës ka mangësi në politikat e kontraktimit për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit ASYCUDA

Organizata duhet të zbatoj politikat organizative mbi kontraktimin.¹⁰ Kërkesat e sigurisë së organizatës duhet të jenë të theksuara nga kontraktori në mënyrë të përshtatshme në marrëveshjet me palët e jashtme.¹¹

Dogana e Kosovës duhet të zbatoj marrëveshjen e nënshkruar duke përfshirë nenin që ka paraparë promovimin e barazisë gjinore me pjesëmarrjen e punonjësve femra në projekt.¹²

DK për të zhvilluar sistemin AW ka nënshkruar marrëveshje me UNCTAD në vitin 2011, në të cilën marrëveshje janë përcaktuar kushtet për zhvillimin e këtij sistemi, mirëpo nga analizimi i dokumenteve¹³ dhe intervistave me zyrtarë, kemi vërejtur që DK nuk ka arritur që në këtë marrëveshje të adresoj kërkesat për sigurinë e informacionit duke mos e përfshirë në termet e kontratës bazë që është lidhur më 6 maj 2011. Për kontraktim i referohen ligjit të prokurimit dhe procedurave të parapara në këtë ligj, që nuk është paraparë politikë e veçantë për sigurinë e informacionit, por është përshkruar vetëm në formë të përgjithshme. Në vitin 2017 DK ka hartuar politika, procedura dhe standarde për sigurinë e informacionit, të cilat aktualisht i përdor, mirëpo ka vazhduar të mos adresoj çështjet e sigurisë edhe në kontratat në vazhdim për mirëmbajtjen dhe avancimin e sistemit AW. Këtë mangësi, zyrtarët përgjegjës për sistemin AW e arsyetuan me qasjen e kontraktorit vetëm në ambientin e zhvillimit dhe jo në atë real, mirëpo ne kemi vërejtur se baza e të dhënave përmban edhe të dhëna reale.

Mirëpo, DK ka arritur të zbatojë kërkesat për barazi gjinore, të cilat kanë qenë të parashikuara në marrëveshjen me UNCTAD. Në sektorin e ASYCUDA-së, i cili përbëhet nga tre zyrtarë, dy prej tyre janë të gjinisë mashkullore dhe një femërore.

10 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontraktimi, Siguria

11 ISO 27001 – Politikat e Sigurisë së Informacionit.

12 Shtojca 2 e Marrëveshjes ndërmjet Doganës së Kosovës dhe Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), Mars 2023.


13 Kontrata e nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë së Specializuar të Kombeve të Bashkuara, UNCTAD; Kontratat e punës; Vendimet e drejtorit për transferim.

Mungesa e trajtimit të sigurisë së informacionit dhe mangësitë në politikat e kontraktimit për sigurinë e informacionit rrezikojnë sigurinë e sistemeve të kontraktuara dhe në rast të ndonjë incidenti të sigurisë së informacionit nuk ka mundësi të identifikohet përgjegjësia e palëve në kontratë, si dhe monitorimi dhe raportimi i incidentit.

3.2. Siguria e Informacionit

Siguria e informacionit është një nga aspektet themelore të qeverisjes së TI-së për të siguruar disponueshmërinë, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave. Për menaxhim më të mirë të sigurisë së informacionit, institucioni, duhet të krijojë mekanizma që të mundësojë menaxhimin e rreziqeve të lidhura me sigurinë, marrjen e masave të duhura dhe garancinë se informacioni është i disponueshëm, i përdorshëm, i plotë dhe i pa komprometuar.¹⁴

Figura 5. Parimet e sigurisë së informacionit



¹⁴ Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Siguria e Informacionit.

2. Dogana e Kosovës nuk ka një politikë sigurie të përditësuar

Dogana e Kosovës duhet të dokumenton, aprovon dhe komunikon politikat dhe procedurat e duhura për të udhëzuar operacionet e biznesit dhe të TI-së, me qëllim të arritjes të mandatit të saj. Politikat e sigurisë së informacionit duhet të mbulojnë të gjitha rreziqet operationale dhe të kenë mundësi të mbrojnë në mënyrë të arsyeshme të gjithë asetet e informacioneve kritike kundrejt humbjeve, dëmtimit dhe abuzimit. Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit dhe politika të tjera të brendshme, procedura ose rregulla të aplikueshme, duhet të sigurojnë që janë në përputhje me zhvillimet e fundit të organizatës dhe rishikohen rregullisht.¹⁵

DK ka një politikë të sigurisë së informacionit, mirëpo kjo politikë e sigurisë nuk është e përditësuar. Në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 02/2010 të MAP, për menaxhimin e sigurisë së informacionit, DK në vitin 2017, ka hartuar politika, procedura dhe standarde për sigurinë e informacionit, të cilat përdoren edhe aktualisht, mirëpo kjo politikë nuk është përditësuar ende. Prandaj, zhvillimet e realizuara në DK dhe në sigurinë e informacionit globalisht që prej vitit 2017 dhe deri në vitin 2024 nuk janë të përfshira në këtë politikë.

Shkaku për mos përditësimin e kësaj politike dhe politikave tjera që lidhen me procedurat doganore dhe TI-në është planifikimi i përditësimit të tyre pas hyrjes në fuqi të Kodit nr. 08/L-247 Doganor dhe të Akcizave në mënyrë që të përshtaten. Prandaj, tani janë në proces avancimi për t'u adaptuar me Kodin e ri Doganor.

Politika e sigurisë e pa përditësuar dhe mungesa e udhëzimeve të reja mbi praktikën e sigurisë, lë punonjësit të painformuar dhe të paaftë të mbrojnë organizatën në mënyrë efektive dhe e bëjnë më të cenueshme organizatën ndaj sulmeve kibernetike.

¹⁵ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Informacionit dhe Siguria Kibernetike, Politikat e sigurisë së informacionit dhe ISO 27000.

3. Mangësitë në strukturën e sigurisë së TI-së dhe ndarjen e përgjegjësive, si dhe ndikimi në menaxhimin e gjurmëve të auditimit në sistemin e informacionit të DK-së

Dogana e Kosovës duhet të ketë detyra dhe përgjegjësi të qarta të TI-së lidhur me Politikën e Sigurisë së Informacionit, nuk duhet të ketë konflikte përgjegjësish ose jo-harmoni në aktivitetet e sigurisë së informacionit. (referuar ISO 27000).¹⁶

Gjatë periudhës së auditimit, analizave të dokumenteve për organizimin e TI-së në Doganë dhe intervistave me zyrtarët përgjegjës kemi vërejtur se Dogana e Kosovës nuk ka arritur të krijoj një strukturë të qartë të sigurisë së informacionit. Zyrtarët e TI-së në Doganë të cilët administrojnë bazën e të dhënave, kanë qasje të plotë në bazën e të dhënave dhe në aplikacion të ASYCUDA World, ata po ashtu kanë qasje të plotë në regjistrat e gjurmëve të auditimit. Ndërsa analizimin e gjurmëve të auditimit ata e bëjnë me rastin e ndonjë kërkese, siç ishte rasti i auditimit të jashtëm. Përveç kësaj, në departamentin e TI-së është e theksuar fokusimi i përgjegjësive dhe varësisë së plotë nga një zyrtar me qasje administruese në të gjitha sistemet dhe bazat e të dhënave që posedon DK.

Si dhe, në strukturën organizative të miratuar në vitin 2016, së bashku me shtojcën e saj që detajon detyrat dhe përgjegjësitë e secilit sektor të DK-së dhe e përditësuar në vitin 2019, përfshinte dispozita për sektorin e sistemeve, sigurisë dhe infrastrukturës. Megjithatë, nuk përcakton në mënyrë specifike përgjegjësinë për monitorimin e sigurisë së informacionit, si dhe nuk përcakton një rol të veçantë për mbikëqyrjen e gjurmëve të auditimit brenda sistemeve të informacionit dhe bazave të të dhënave.

Gjithashtu, gjatë auditimit, përkatësisht vëzhgimit fizik në pikat doganore është vërejtur se pas plotësimit të shënimeve nga agjentët doganor në sistemin ASYCUDA dhe mbërritjes së kamionit, importet për kontrolle në kanalën e kuq duhet të inspektohen fizikisht nga zyrtari doganor, i cili e kryen këtë detyrë i vetëm dhe jo me kolegët e tij në formë të komisionit, edhe pse gjatë përshkrimit të proceseve doganore në intervista neve na u prezantua se këtë proces e realizojnë

16 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Informacionit dhe Siguria Kibernetike, Struktura e sigurisë së TI-së.

si ekip. Po ashtu, menaxhmenti i DK-së ishte i bindur se këtë proces e realizojnë më shumë zyrtarë dhe jo një zyrtarë i vetëm, përkundër se udhëzimi numër 17/2015, parasheh realizimin e këtij procesi nga një zyrtar.

Mungesa e një strukture të përcaktuar të sigurisë së informacionit ka shkaktuar konflikt të përgjegjësive në qasjet e zyrtarëve në sistemet e saj dhe mos arritur të klasifikoj nivelin e sigurisë së informacionit. Qasja e plotë në gjurmët e auditimit që i jepet administratorit të bazës së të dhënave dhe të aplikacioneve, e mbështetur vetëm te një zyrtar i vetëm, krijon rreziqe të konsiderueshme. Këto përfshijnë mundësin për ndryshime të paautorizuara, gabime ose keqpërdorime të të dhënave, të tilla si anashkalimi ose fshirja e gjurmëve të auditimit, gjë që cenon integritetin e sistemit.

Ndërsa realizimi i kontrollit fizik të mallit rrezikon transparencën e procesit dhe saktësinë e vlerësimit.

4. Mungesë e ndërgjegjësimit dhe trajnimeve të sigurisë së informacionit për punonjësit e DK-së

Dogana e Kosovës duhet të sigurohet se të gjithë punonjësit (përfshirë të kontraktuarit ose përdoruesit e të dhënave sensitive) janë të kualifikuar për mirëmbajtjen e të dhënave, përdorimin e burimeve, kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë. Që prej rekrutimit e deri në shkëputjen e marrëdhënieve të punës personeli duhet të ruaj Sigurinë e Informacionit. Sapo të ndërpritet kontrata e punësimit/kontraktimit qasja e tyre duhet të ndërpritet. Po ashtu të i'u ofrohen trajnime periodike rifreskuese për aftësitë dhe njohuritë e duhura ndaj punonjësve, roli i të cilëve në organizatë është domethënës për Sigurinë e Informacionit dhe Kibernetikës.¹⁷

Gjatë ekzaminimeve në pikat doganore kemi identifikuar që punonjësit e Doganës nuk janë mjaftueshëm të ndërgjegjësuar lidhur me sigurinë e informacionit. Kemi vërejtur se ata ruajnë fjalëkalimet e tyre të të ekspozuar në hapësirat e punës,

¹⁷ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Informacionit dhe Siguria Kibernetike, Siguria e TI-së e Burimeve Njerëzore.

lehtësisht të qasshme për palët e treta pa qenë të vetëdijshëm për ruajtjen e qasjes dhe sigurinë e informacionit.

Edhe pse janë dërguar njoftime për sigurinë e informacionit përmes postës elektronike nga Departamenti i TI-së tek të gjithë zyrtarët, mungojnë trajnimet mbi sigurinë e informacionit. Arsyetimi i zyrtarëve për ekspozimin e fjalëkalimeve ishin politika e vështirë për kompleksitetin e fjalëkalimit dhe koha e shpeshtë për ndryshimin e fjalëkalimit, si dhe numri i madh i fjalëkalimeve që përdorin për sisteme të ndryshme.

Mos ruajta e duhur e qasjes në sistem rrezikon të dhënat dhe qasjen nga persona të pa autorizuar. Gjithashtu, rrezikon realizimin e ndonjë procesi të rëndësishëm doganor përmes asaj qasje nga persona të pa autorizuar dhe mos identifikimin e tyre.

5. Dogana e Kosovës nuk ka procedurë për kontrollin e qasjes së përdoruesve në sistemin e informacionit

Politikat e qasjes në sistemet e informacionit në Doganën e Kosovës duhet të japin një bazë për kontrollin e ndërhyrjes ndaj informacioneve. Funkzioni i sigurisë së informacionit monitoron efektivitetin e kontrollit të operacioneve të menaxhimit të llogarive të përdoruesve në kohë dhe raporton efikasitetin dhe efektivitetin e operimit.¹⁸ Ndarja dhe përdorimi i privilegjeve në mjedisin e sistemit të informacionit duhet të jetë i kufizuar dhe i kontrolluar, d.m.th., privilegjet ndahen në bazë të nevojës për përdorim, privilegjet ndahen vetëm pas procesit formal të autorizimit.¹⁹

Në sistemin AW që e ka të zbatuar DK kanë qasje zyrtarët doganor dhe agjentët doganor që janë përdorues të jashtëm dhe që kanë qasje për regjistrimin e të dhënave doganore, për realizimin e proceseve doganore. Mirëpo, DK nuk ka një procedurë të shkruar për kontrollin e qasjes në sistemet e informacionit, pasi që ata nuk e kanë parë të arsyeshme, duke qenë se komunikimi me email për lejimin dhe

18 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Informacionit dhe Siguria Kibernetike, Kontrolllet e qasjes.

19 ISO 27001 – Kontrolllet e Qasjes.

ndryshimin e qasjeve ishte më i thjeshtë, një procedurë sipas tyre do të shkaktonte vonesë, prandaj nuk e kanë një proces të caktuar për sigurimin e qasjes në sistemin e informacionit, por në praktikë përdorin tri metoda.

Metoda e parë për plotësimin e një forme për qasje në sistemet kompjuterike dhe aplikacione. Kjo metodë është përdorur që nga viti 2004–2020, por pasi që ka shkaktuar vonesa, nga varësia e nënshkrimeve nga udhëheqësit e sektorëve, atëherë këtë metodë e kanë eliminuar dhe kanë vazhduar të përdorin metodën e dytë.

Metoda e dytë e ndryshimeve të qasjeve bëhet me vendim të drejtorit të përgjithshëm, i cili nënshkruan transferimin e stafit në sektor të ndryshëm dhe pozita të ndryshme dhe ky vendim dërgohet në sektorin për administrimin e sistemit AW. Bazuar në këtë vendim ata realizojnë ndryshimet në sistemet doganore, përfshirë edhe sistemin AW.

Metoda e tretë e ndryshimeve të qasjeve bëhet sipas kërkesës së udhëheqësit të sektorit, në degët doganore ose pikë kalimet kufitare, i cili dërgon e-mail me informatat përkatëse për ndryshim për qasjet e zyrtarëve doganor.

Këto tri metoda janë përdorur vetëm për përdoruesit e brendshëm – zyrtarët doganor, ndërsa agjentët doganor bëjnë kërkesën përmes Shoqatës së Shpeditereve Vendor dhe Ndërkombëtar të Kosovës ashtu siç është përcaktuar në marrëveshjen e vitit 2015.

Gjithashtu, si mungesë e procedurës për kontrollin e qasjeve në sistemet doganore nuk realizohen rishikime të qasjeve në listën e përdoruesve në baza të rregullta, në sistemin e informacionit. Pjesa më e ndjeshme e listës së përdoruesve është lista e përdoruesve të agjentëve doganor (5250 përdorues me qasje të agjentëve doganor), të cilët edhe përkundër ndryshimeve vazhdojnë të përdorin llogari të kolegëve të tyre përfshirë edhe ata që nuk janë në marrëdhënie pune.

Procesi i menaxhimit të qasjes përmes kërkesave që bëhen nga posta elektronike sipas tyre është më i shpejt. Sa i përket rishikimit të qasjeve në baza të rregullta nuk e kanë parë të nevojshme duke qenë se çdo kërkesë për ofrimin dhe largimin e qasjes realizohet. Edhe pse sipas standardeve për sigurinë e informacionit rishikimi i qasjeve të përdoruesve duhet të realizohet të paktën një herë në vit. Ndërsa sipas

DK-së për qasjet e agjentëve doganor ekziston marrëveshja e vitit 2015 mes DK-së dhe Shoqatës së Shpeditereve Vendor dhe Ndërkombëtar të Kosovës që përcakton formën e qasjes së agjentëve doganor dhe sipas së cilës mundësohen qasjet e tyre.

Mungesa e një procedure për kontrollimin e qasjes së përdoruesve në sistemin e informacionit rrit rrezikun e keqpërdorimit të qasjeve dhe përdorimit të qasjeve të paautorizuara, si dhe krijon pasiguri për shkak të mungesës së rishikimit të listës së përdoruesve dhe të një procesi të qartë për aprovimin dhe heqjen e qasjeve.

3.3. Plani i Vazhdimësisë së Biznesit – Plani i Rikthimit nga Fatkeqësia

Organizata duhet të ketë edhe një plan të vazhdimësisë për të siguruar edhe vazhdimësinë e ofruesit të shërbimit për veprimtarinë e tyre ose të marrë përsipër këtë nga një kompani tjetër. Nëse rimëkëmbja nga fatkeqësitë të një fushe kritike funksionale rrezikohet, do të rrezikohet vazhdimësia e biznesit (veprimtarisë). Nëse rolet dhe përgjegjësitë nuk janë të qarta dhe nuk janë kuptuar nga personeli përkatës, edhe plani i mirë i vazhdimësisë gjithashtu mund të bëhet joefektiv.²⁰

20 Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, PVB – PRF.

Figura 6. Vazhdimësia e biznesit



6. Dogana e Kosovës nuk ka një plan për vazhdimësinë e biznesit

Dogana e Kosovës duhet të mbuloj të gjitha fushat kritike të organizatës në grup. Kërkesat për detyrat dhe përgjegjësitë për anëtarët e grupit.²¹ Testet e planit të vazhdimësisë së biznesit duhet të sigurojnë që të gjithë anëtarët e ekipit të rimëkëmbjes dhe stafi tjetër përkatës janë të vetëdijshëm për planet dhe përgjegjësinë e tyre për vazhdimësinë e biznesit dhe sigurinë e informacionit dhe e dinë rolin e tyre kur evokohet plani.²²

DK nuk posedon politikë, procedurë apo manual specifik për planin e vazhdimësisë së biznesit, por sistemi ASYCUDA është i konfiguruar ashtu që baza e shënimeve replikohet (bëhet kopje përsëritëse) në kohë reale përmes platformës Oracle ActiveDataguard. DK posedon dy qendra të dhënash të cilat janë të lidhura në mes

21 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – PVB – PRF - Struktura e FunkSIONIT të Vazhdimësisë së Biznesit.

22 ISO 27001 – Struktura e funksionit të vazhdimësisë së biznesit.

vete me fije optike, replikimi bëhet përmes platformës VMware, po ashtu kanë replikim edhe përmes platformës Storage-to-Storage (3PAR8400 – 3PAR8200).

Gjithashtu nuk e kanë të caktuar një strukturë të caktuar të personave përgjegjës që është në funksion për realizimin e planit të vazhdimësisë së biznesit, në rast të ndonjë fatkeqësie apo emergjence që do të shkaktonte ndërprerje të proceseve në sistemin e informacionit, duke qenë se nuk ka edhe një plan të caktuar për vazhdimësinë e biznesit që do të përcaktonte këtë strukturë.

Edhe pse DK ka përshtatur zbatimin e sistemit AW bazuar në legjislacionin doganor të Kosovës, duke u mbështetur edhe nga procedurat e veta të përgjithshme, që i ka të shkruara, nuk mund të mbështesë plotësisht vazhdimësinë e biznesit në to duke qenë se këto procedura janë të vjetërsuara dhe nuk janë përditësuar përgjatë kohës së zhvillimit dhe avancimit të sistemit.

Çdo proces që realizohet përmes sistemit ASYCUDA është sipas legjislacionit doganor të Kosovës, kështu që këto procese janë të shumta dhe komplekse. Diagrame specifike për të gjitha proceset e punët nuk i posedojnë, pasi që sistemi është adaptuar varësisht legjislacionit doganor në fuqi.

Stafi i Doganës së Kosovës është pjesë e grupeve punuese të Qeverisë dhe të dhënat e Doganës ruhen në qendrat e të dhënave në objektet e Qeverisë. Por, janë ndërmarr edhe veprime teknike për vazhdimësinë e biznesit përmes replikimeve dhe ruajtjes së të dhënave në dy vende të ndryshme. Sa i përket strukturës ajo nuk është përcaktuar në mungesë të një plani, por zyrtarë të TI-së në baza të rregullta kujdesen për mbikëqyrjen e kopjes rezervë. Sa i përket përditësimit të procedurave kemi marr informacion edhe nga auditimi i brendshëm se kanë sugjeruar hartimin dhe përditësimin e procedurave që shpjegojnë proceset doganore dhe ato të sistemit të informacionit, por ende nuk kanë arritur të i realizojnë.


Në rast fatkeqësie, humbje të të dhënave, dëmtim të sistemit ose largim të stafit kyç, mungesa e një plani gjithëpërfshirës të vazhdimësisë së biznesit përbën një rrezik të konsiderueshëm për operacionet. Kjo përfshin mungesën e një strukture të përcaktuar për zbatimin e një plani të tillë dhe mungesën e procedurave të shkruara për aktivitetet doganore të kryera nëpërmjet sistemit ASYCUDA, i cili menaxhon të dhënat dhe proceset kritike doganore. Këto boshllëqe rrezikojnë aftësinë e Doganës për të mbajtur operacione të pandërprera gjatë emergjencave.

3.4. Kontrollat e aplikacionit

Kontrollat e aplikacionit janë: kontrolli mbi funksionin e hyrjes, të përpunimit dhe të daljes. Ato përfshijnë metoda për të siguruar që: vetëm të dhëna të plota, të sakta dhe të vlefshme vendosen dhe azhurnohen në një sistem të informacionit, përpunimi realizon detyrën e saktë dhe rezultati i përpunimit plotëson pritjet dhe të dhënat ruhen.²³

Sistemi **ASYCUDA World**, që përdor Dogana e Kosovës, përfshin një sërë kontrollesh të automatizuara dhe manuale që synojnë të sigurojnë integritetin dhe sigurinë e të dhënave doganore. Në përgjithësi, këto kontrolle ndihmojnë në lehtësimin e funksionimit të sistemit dhe garantimin e përputhshmërisë me rregulloret, mirëpo ka mangësi në kontrollet hyrëse dhe të përpunimit në sistemin e informacionit AW.

Figura 7. Modeli hyrje-përpunim i të dhënave në sistemin e informacionit AW



23 Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Kontrollat e aplikacionit

7. Kalkulimin i koeficientit për përcaktimin e çmimit në ASYCUDA realizohet në formë manuale

Rregullat e vlefshmërisë duhet të jenë të mirë-hartuara dhe të zbatuara në ndërveprimin e hyrjeve (inputit); të dhëna jo valide duhet të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni; duhet të ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë së kontrolleve thelbësorë të hyrjes; ka kontrolle dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit.²⁴

Gjatë procesit të doganimit mallrat që kalojnë në procesin e kontrollit ato vlerësohen sipas targetimit të kriterëve të rrezikut, të cilat kanalizojnë lëndën në kanalin me rrezik të lartë (kanali i kuq), rrezik të mesëm (kanali i verdhë) dhe rrezik të ulët (kanali i gjelbërt). Lëndët në kanalin e kuq, i nënshtrohen kontrolleve fizike, lëndët në kanalin e verdhë i nënshtrohen kontrolleve dokumentare dhe lëndët në kanalin e gjelbër kalojnë pa ju nënshtroar kontrollit. Pastaj, sektori në zyrën qendrore për vlerësimin e lëndëve të cilat janë në kanalin e verdhë analizon dokumentacionin burimor dhe vlerëson përshtatshmërinë e çmimit të deklaruar në Dokumentin Unik Doganor (DUD) nga ana e palëve sipas neneve përkatëse të Kodit Doganor të Kosovës për vlerësim.

Në momentin që zyrtari doganor konstaton se çmimi i deklaruar në DUD, duhet të ndryshohet pas krahasimit me burimet e brendshme dhe të jashtme të çmimeve, ky i fundit në formë manuale duhet të kalkulojë koeficientin e përcaktimit të çmimit (përshkrimi 45 në DUD-rregullimi) jashtë sistemit, pastaj duhet të vendosë në sistemin ASYCUDA pa ndonjë kontrolle hyrëse në sistem, që të verifikoj saktësinë e të dhënave në mënyrë që të gjenerohet në DUD çmimi i mallit i ndryshuar/vlerësuar nga Dogana.

Sistemi ASYCUDA nuk e mundëson kalkulimin e koeficientit për përcaktimin e çmimit në formë automatike brenda sistemit, pasi që nuk është kërkuar nga njësia e biznesit dhe nuk është dhënë ndonjë shembull se si të realizohet.

24 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.

Duke qenë se zyrtari doganor bën kalkulim e koeficientit për përcaktimin e çmimit në formë manuale, mund të bëhet ndonjë gabim gjatë kalkulimit dhe të mos vendos vlerën e saktë.

8. Ri kanalizimi i lëndëve nga kanali i gjelbër në kanalin e kuq

Duhet të dokumentohen metoda të ndryshme për futjen e të dhënave; të dhëna jo valide duhet të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni; kriteret e vlefshmërisë përditësohen në mënyrën e duhur dhe të autorizuar; duhet të ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë së kontrolleve thelbësorë të hyrjes; ka kontrolle dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit.²⁵ Duhet të ketë kontrolle dokumentare dhe fizike të mallrave që dalin në kanalin e kuq (ekipet e shikimit), si dhe kontrolli dokumentar në kanalin e verdhë.²⁶

Zyrtari doganor (mund të jetë edhe udhëheqësi i ndërrimit/udhëheqësi i njësisë), 15 minuta pasi sistemi e kanalizon lëndën në kanalin e gjelbërt mund ta rikthejë atë në kanalin e kuq nëse konstaton se duhen ekzaminime shtesë dhe ka informata që duhet të konfirmohen. Pa pasur dokumentim për arsyen e ri-kanalizimit, apo mundësi kontrolli nga sistemi në rast të gabimit në ri-kanalizim të lëndës.

Në rastet e testuara zyrtari doganor apo personi që e ka rikthyer lëndën në kanalin e kuq nuk jep ndonjë koment apo arsyetim për këtë veprim. Për këtë veprim nuk ka një procedurë që obligon zyrtarin doganor të shkruaj koment, por as sistemi nuk ka ndonjë fushë për koment, për të shkruar arsyen e ri-kanalizimit. Edhe pse standardet për kontrollet hyrëse të aplikacionit sugjerojnë verifikim dhe dokumentim të vendosjes së të dhënave në sistem.

Kjo ndikon në mungesë të pasqyrës së rasteve me rrezik për sektorin e menaxhimit të riskut si dhe të transparencës dhe llogaridhënies për punën e zyrtarit në pikë doganore. Po ashtu sjellë mangësi në raportet e gjendjes për vendimmarrje nga menaxhmenti.

25 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.

26 Dogana e Kosovës – Identifikimi i Rreziqeve për Doganën e Kosovës 2023.

9. Sistemi ASYCUDA nuk bën validimin e të dhënave për numër personal/ biznesit dhe markat tregtare

Të dhënat jo valide duhet të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni; kriteret e vlefshmërisë përditësohen në mënyrën e duhur dhe verifikohen me regjistrat themelor të të dhënave.²⁷ Përfshirë numrin personal dhe numrin e biznesit. Gjithashtu, duhet të bëhet identifikimi i markave tregtare gjatë fazës së zhdoganimit në DUD rubrika 31 e DUD-it, në mënyrë që pas shënimit të markës tregtare sistemi AW të paralajmërojë se a është markë e mbrojtur.²⁸

Gjatë regjistrimit të deklaratës nga agjentët doganor, kemi parë se në të gjitha rastet e regjistrimit të numrit personal dhe numrit të biznesit, ata përshkruajnë numrin në formë manuale dhe nuk verifikohet nga baza e të dhënave të regjistrimit civil apo regjistrimit të bizneseve.

Numri personal dhe numri i biznesit janë të dhëna të Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, ndërsa Dogana nuk ka krijuar ndërlidhje për disa nga fushat që përdor sistemi ASYCUDA, edhe pse na ka prezantuar një marrëveshje të shkruar me Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, në sistem nuk është realizuar një ndërlidhje teknike.

Gjithashtu, gjatë kontrolleve që realizojnë zyrtarët doganor, kemi parë se sistemi ASYCUDA nuk njofton për rastet e markave tregtare të mbrojtura, mirëpo ata kanë një sistem të ndarë (INES) që janë të listuara markat e mbrojtura tregtare nga DK dhe listat në dokumente që i verifikojnë në formë manuale mallrat nëse janë marka tregtare të mbrojtura.

Për më tepër të dhënat për markat tregtare të cilat regjistrohen në sistemin INES që përdor DK nuk ka mundësi teknike të krijojnë ndërlidhje me sistemin ASYCUDA. Sistemi themelor që ruan këto të dhëna INES është i kufizuar dhe limiton mundësitë e shkëmbimit të të dhënave me sistemin AW.

27 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrolllet e Aplikacionit, Kontrolllet e hyrjes.

28 Dogana e Kosovës – Identifikimi i Rreziqeve për Doganën e Kosovës 2023.

Mungesa e këtyre ndërlidhjeve për validimin e të dhënave mund të rezultojë me ndonjë gabim të qëllimshëm ose pa qëllimshëm dhe mos verifikimin e tij në kohë reale. Në rastet e depërtimit të ndonjë malli pa verifikimin e markës tregtare të mbrojtur nga DK do të shkaktonte dëm për markën tregtare dhe qytetarin. Si dhe, mos respektim të marrëveshjes me listën e tregtarëve që ka DK për mbrojtjen e markave tregtare.

10. Modulet për vendosjen e kritereve dhe vendosjen e tarifave në sistemin ASYCUDA nuk janë të përshtatshme dhe të thjeshta për përdoruesin

Aplikacioni duhet të identifikon në mënyrë korrekte gabimet në transaksione. Duhet të ekziston një mekanizëm i përshtatshëm për trajtimin e gabimeve në përpunim.²⁹ Zyrtarët nga sektori përkatës në kontinuitet duhet të merren me rifreskimin e vlerësimit të rrezikut, pranojnë informata dhe i procesojnë në sistemin ASYCUDA World, të cilat më pas mund të lexohen në formë të kritereve gjatë fazës së ekzaminimit, si dhe çdo shfrytëzues i AW, po ashtu bazuar në këto kritere (nivele të rrezikut) lëndët ri-kanalizohen nga vetë sistemi AW në kanalën e Verdhë, Kaltër, Gjelbër dhe Kuq.³⁰

Moduli për vendosjen e kritereve në ASYCUDA nuk është i thjeshtë për përdorim, zyrtarët përgjegjës të sektorit të riskut duhet të jenë të vëmendshëm të kuptojnë bazat e të dhënave dhe sintaksën e gjuhëve programuese, pasi që vendosja e kriterit në ASYCUDA kërkon njohuri specifike. Prandaj, gjatë prezantimit të këtij moduli ne kuptuam që për shkak të kësaj forme që është i dizajnuar moduli, ka pas raste të gabimeve në sintaksë gjatë vendosjes së kritereve, që kanë rezultuar edhe te kriteret në sistem real.

Gjithashtu, moduli për vendosjen e tarifave nuk është i thjeshtë për përdorim (user friendly), zyrtarët duhet të shkruajnë formulat e kalkulimit në secilën hapësirë për ndryshimin e një tarife. Ndërsa në rastet e ndryshimeve të shumë tarifave, sistemi ASYCUDA nuk mundëson që të bëjnë zëvendësimet e të gjitha tarifave përnjëherë në formë automatike, por duhet të realizojnë ndryshimin një nga një për secilën, që

29 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrolllet e aplikacionit, Kontrolllet e përpunimit.

30 Dogana e Kosovës – Identifikimi i Rreziqeve për Doganën e Kosovës 2023.

merr kohë dhe lë mundësi për gabime, ku gjatë ekzekutimit na janë paraqitur raste të shfaqjes së gabimeve.

Realizimi i këtyre moduleve është bërë në këtë formë pasi që ASYCUDA është sistem i gatshëm dhe opsionet që i ofron janë të përgjithësuara për të gjithë përdoruesit e AW në të gjitha vendet e botës ku përdoret. Zyrtarët e Doganës pohuan që për modulën e kritereve të riskut është diskutuar në një konferencë të UNCTAD pasi ishte kërkuar ndryshim, por DK nuk kishte bërë ndonjë kërkesë në formë zyrtare të shkruar për këtë çështje.

Ndryshimi dhe vendosja e kritereve dhe tarifave në formën ekzistuese në sistemin AW ndikon në efikasitetin e punës së këtyre dy sektorëve dhe komplet përdoruesve të AW që përdorin kriteret dhe tarifën, duke lejuar edhe mundësin e gabimeve në të dhënat e regjistruara nga sektorët përkatës dhe duke ndikuar negativisht në funksionimin e sistemit.

11. Sistemi ASYCUDA nuk realizon vlerësimin e rrezikut në mënyrë automatike dhe të matshëm

Zyrtarët nga sektori përkatës në kontinuitet duhet të merren me rifreskimin e vlerësimin të rrezikut, pranojnë informata dhe i procesojnë në sistemin ASYCUDA World, të cilat më pas mund të lexohen në formë të kritereve gjatë fazës së ekzaminimit, si dhe çdo shfrytëzues i AW, po ashtu bazuar në këto kritere (nivele të rrezikut) lëndët ri-kanalizohen nga vetë sistemi AW në kanalën e Verdhe, Kaltër, Gjelbër dhe Kuq.³¹

Sektori i riskut në kuadër të Doganës së Kosovës bazuar në hulumtimet e brendshme, historikun e importit nga e kaluara dhe ai i operatorëve ekonomik, përcakton kriteret të cilat duhet të merren parasysh gjatë procesit të zhdoganimit për kategoritë e caktuara.

31 Dogana e Kosovës – Identifikimi i Rreziqeve për Doganën e Kosovës 2023.

Kriteret futen në sistem nga sektori i riskut në formë tekstuale, të gjitha kriteret shkruhen si tekst me një fushë të caktuar dhe zyrtari doganor i lexon këto kritere dhe duhet t'i krahasoj kriteret me dokumentet e paraqitura nga pala në proces të zhdoganimit. E gjithë kjo kryhet në formë manuale me dhënie të komentit nga zyrtari doganor, i cili plotëson fushën “akti i inspektimit” me një tekst të formuluar në formë raporti. Por që nuk ka ndonjë parametër të caktuar për të njoftuar nivelin e rrezikut nga zbatimi i atyre kritereve, se cilat kritere janë zbatuar e cilat jo me një shifër të saktë statistikore në formë automatike, të matshme dhe në kohë reale.

DK nuk ka një procedurë që përcakton si të realizohet vlerësimi i rrezikut dhe përcaktimi i kritereve, që do të ndihmonte në zhvillimin e këtij procesi edhe në sistem. Gjithashtu, ndarja e detyrave dhe mungesa e aprovimit formal në proces të përcaktimit të kritereve, nuk është e definuar.

Mungesa e miratimit formal dhe ndarja e paqartë e përgjegjësi në përcaktimin e kritereve të rrezikut mund të ndikojë në qëndrueshmërinë e vendimmarrjes, duke krijuar mundësi për trajtim jo të njëtrajtshëm të rasteve dhe sfida në adresimin e prioriteteve të rrezikut. Gjithashtu, kjo situatë mund të kufizojë pasqyrën (feedback-un) e plotë dhe periudhën efikase për sektorin e riskut mbi kriteret e përcaktuara, duke e bërë më sfidues procesin e monitorimit dhe analizimit të tyre. Kjo mund të ndikojë në efikasitetin e vendimmarrjes dhe alokimin e burimeve.

KONKLUZIONEN

04

4. Konkluzionet

Dogana e Kosovës ka bërë përparime të rëndësishme drejt digjitalizimit të proceseve doganore, duke përmirësuar efikasitetin dhe transparencën në menaxhimin e operacioneve të saj. Ky progres është arritur përmes zbatimit të sistemit ASYCUDA World, i cili mundëson automatizimin e një pjese të konsiderueshme të procedurave doganore, duke reduktuar burokracinë dhe përshpejtuar proceset. Sistemi lejon regjistrimin dhe përpunimin elektronik të dokumentacionit doganor, si dhe shkëmbimin e të dhënave në kohë reale ndërmjet agjentëve doganorë, operatorëve ekonomikë dhe institucioneve të tjera relevante. Përmes përdorimit të këtij sistemi, Dogana e Kosovës ka arritur të përmirësojë monitorimin e fluksit të mallrave. Megjithatë, digjitalizimi mbetet një proces i vazhdueshëm, dhe sfidat si përshtatja e mëtejshme e kriterëve të rrezikut, integrimi i plotë i sektorëve dhe ofrimi i mbështetjes teknologjike kërkojnë përkushtim të vazhdueshëm për të arritur një nivel të plotë të digjitalizimit.

Kontraktimi

Dogana e Kosovës edhe pse ka arritur të zbatoj marrëveshjen për sistemin ASYCUDA lidhur me zhvillimin, avancimin dhe mirëmbajtjen e sistemit, si dhe përmes këtij projekti ka arritur të zbatoj edhe kërkesën e UNCTAD për promovimin e barazisë gjinore. Dogana e Kosovës nuk ka arritur që përmes marrëveshjes të përcaktoj qartë përgjegjësitë dhe detyrat e palëve në proces për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit duke e lënë sigurinë e sistemit të informacionit të pa adresuar dhe të cenueshme.

Informacioni dhe siguria kibernetike

Dogana e Kosovës ka mangësi në kontrollat për sigurinë e informacionit në mungesë të një strukture të qartë të sigurisë së TI-së. Me një nivel të ulët të ndërgjegjësimit të punonjësve lidhur me sigurinë e informacionit, ka mungesë të procedurës për kontrollin e qasjes së përdorueseve dhe ka një politikë për sigurinë e informacionit të pa përditësuar. Gjë që në vazhdimësi i ekspozohet rrezikut për ruajtjen e sigurisë

së informacionit ndaj dëmtimit, ndryshimit dhe humbjes pa mundësi të identifikimit dhe parandalimit në kohë.

Plani i Vazhdimësisë së Biznesit – Plani i Rikthimit nga Fatkeqësia

Dogana e Kosovës nuk ka politikë efektive për vazhdimësinë e biznesit në organizatë si mungesë e planit të vazhdimësisë së biznesit, strukturës që do të mundësoj realizimin e planit dhe procedurave të shkruara doganore që realizohen përmes sistemit ASYCUDA.

Kontrollet e aplikacionit

Dogana e Kosovës në vazhdimësi ka zhvilluar sistemin ASYCUDA World për digjitalizimin e proceseve doganore. Mirëpo, nuk ka arritur të siguroj se të dhënat të cilat vendosen në sistem janë të sakta, sepse të dhënat për kalkulimin e koeficientit për përcaktimin e çmimit procesohen në formë manuale. Si dhe, nuk siguron se janë të dhëna valide dhe të besueshme pasi që nuk mund të validoj të gjitha të dhënat që vendosen në sistem edhe në rastet kur janë të dhëna të verifikueshme nga bazat e të dhënave ekzistuese. Për shkak të formës së vendosjes së kriterëve për vlerësimin e rrezikut në këtë sistem DK nuk arrin të ketë një pasqyrë të matshme të paraqitjes së rrezikut. Po ashtu, ky sistem nuk është i lehtë për përdoruesin, nuk ofron mundësi të thjeshta përdorimi, sidomos për modulet e tarifave dhe riskut, prandaj si pasojë ka raste që shfaqen gabime në sistem.

REKOMANDIMET

05

5. Rekomandimet

Rekomandojmë Doganën e Kosovës, që:

1. Politikat e kontraktimit, para se të iniciojë zhvillimin e çdo projekti të teknologjisë së informacionit, duhet që në të gjitha kontratat e zhvilluara të teknologjisë së informacionit të adresojë kërkesat e sigurisë së informacionit.
2. Politika e sigurisë së informacionit, të përditësoj politikat dhe procedurat për të mbrojtur sigurinë e informacionit.
3. Struktura e sigurisë së teknologjisë së informacionit, ndarja e përgjegjësive dhe menaxhimi i gjurmëve të auditimit, të bëj ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive të roleve në sistemet e informacionit dhe të kufizoj veprimet e secilit rol sipas standardeve për ruajtjen e sigurisë së informacionit, duke ndarë rolin e administratorit të bazave të të dhënave dhe administratori i sistemit nga roli i zyrtarit për sigurinë e informacionit. Privilegjet e qasjes në gjurmët e auditimit të i kufizoj dhe monitoroj në baza të rregullta pa shkaktuar konflikt të përgjegjësive dhe duke ruajtur integritetin e të dhënave.
- 3.1 Të rishikoj procedurën e përpunimit të deklaratës doganore në sistemin ASYCUDA World nga oficerët e kontrollit fizik të mallrave, për të realizuar një kontroll fizik më të saktë dhe transparent.
4. Ndërgjegjësimi dhe trajnimet e sigurisë së informacionit për punonjësit e Doganës së Kosovës, të mbahen trajnime për të gjithë zyrtarët doganor lidhur me sigurinë e informacionit dhe të rishikohen mundësitë e realizimit të qasjeve në sistemet e informacionit përmes formës të gjitha sistemet me një qasje të vetme (single sign on).
5. Kontrolli i qasjes së përdoruesve në sistemin e informacionit, të realizoj procedurën për kontrollin e qasjes përmes së cilës duhet të përcaktoj procesin e lejimit dhe largimit të qasjes në sistemin e informacionit, si dhe rishikimin e qasjeve në baza të rregullta.

- 5.1 Të rishikoj marrëveshjen e vitit 2015 mes Doganës së Kosovës dhe Shoqatës së Shpeditereve Vendor dhe Ndërkombëtar të Kosovës që përcakton formën e qasjes së agjentëve doganor dhe të rishikoj qasjet e agjentëve doganor.
6. Plani për vazhdimësinë e biznesit, të hartoj dhe miratoj një plan për vazhdimësinë e biznesit, të përcaktoj strukturën me rolet dhe përgjegjësit për zbatimin e planit. Si dhe, të hartoj një dokument me procedurat e shkruara doganore me proceset të cilat realizohen përmes sistemit ASYCUDA World.
7. Kalkulimi i koeficientit për përcaktimin e çmimit në ASYCUDA World, të automatizohet procesi i kalkulimit të koeficientit të përcaktimit të çmimit nga sistemi ASYCUDA World, në mënyrë që zyrtarët doganorë të mos kenë nevojë ta kryejnë këtë proces manualisht.
8. Ri kanalizimi i lëndëve në sistemin ASYCUDA World, të krijohet fusha mandatore në sistem, që zyrtari doganor, përfshirë edhe udhëheqësin e ndërrimit apo njësisë, të japë një arsyetim ose koment në sistem për veprimet kur rikthen një lëndë nga kanali i gjelbër në kanalin e kuq.
9. Validimi i të dhënave në sistemin ASYCUDA World, të lidhen marrëveshje me institucionet përkatëse që janë pronarë të bazave të të dhënave themelore (Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës) dhe të krijohen zgjidhjet teknike për shkëmbimin e të dhënave me sistemin ASYCUDA World për verifikimin e tyre me bazat e të dhënave themelore.
10. Module të thjeshta për përdoruesin, të bëj përditësimin e sistemit me module më të thjeshta për përdoruesin, duke gjetur formën më të përshtatshme duke lehtësuar përdorimin e modulit për përdoruesit tek sektori i riskut dhe tarifave.
11. Vlerësimi i rrezikut dhe përcaktimi i kritereve, të realizoj një rregullore të brendshme për vlerësimin e rrezikut dhe përcaktimin e kritereve. Si dhe, në sistemin ASYCUDA duhet të mundësohet krijimi i një liste kontrolli për vendosjen e kritereve, në mënyrë që sektori i riskut, ashtu edhe menaxhmenti, të kenë mundësinë të marrin informacionet dhe statistikatat në kohë reale, t'i analizojnë ato dhe të ndërmarrin veprimet e duhura në bazë të analizave të kryera.

Shtojca I. Dizajni i auditimit

Fushat me rrezik dhe treguesit e problemit të auditimit

Dogana e Kosovës ka një mision të gjerë, duke filluar nga mbrojtja e shtetit, ekonomisë dhe qytetarëve. Pra, misioni i Doganës së Kosovës mund të ndahet në dy kategori kryesore:

1. Për çështjet ekonomike - Mbledhja e taksave doganore: Taksa doganore; Tatimit mbi vlerën e shtuar; Akcizën për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Kontrollimi importit dhe eksportit, mbrojtja e ekonomisë; mbrojtja e markave tregtare etj., si dhe statistika të sakta mbi tregtinë me jashtë.
2. Për sigurinë - Luftimi i aktiviteteve ilegale. Rritja e sigurisë përmes prezencës në pikat kufitare; Luftimi i krimit kufitar; Luftimi i trafikut të drogës etj. Mbrojtja e popullatës dhe ambientit, parandalimi kontrabandimit të armëve dhe substancave eksplozive.

Duke e pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e DK, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në raportin e saj vjetor dhe Komisioni Evropian (KE) në Raportin për Kosovën, i ofrojnë hapësirë të veçantë.

Në Raportin për Kosovën të KE-së, është i theksuar progresi i DK-së dhe rëndësia e sistemeve të TI-së, si dhe progresi që DK-ja ka bërë me digjitalizimin e proceseve.

Gjithashtu, edhe ZKA, në Raportin Vjetor të Auditimit (RVA) për vitin 2022, ka identifikuar se ka pasur raste ku nuk kishte harmonizim të plotë të tarifave doganore në TARIK me sistemin ASYCUDA. Kjo pasi që Dogana nuk kishte arritur të bëjë azhurnimin e listës së kodeve dhe nënkodeve tarifore mes dy sistemeve, nuk e kishte të përditësuar listën e plotë të tarifave doganore në sistemin AW.

Për rëndësinë e saj, duke qenë se kjo temë kërkon trajtim të veçantë, pasi që ka të bëjë me auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, ZKA e ka konsideruar si të domosdoshëm auditimin e veçantë nga divizioni i performancës

përkatësisht TI-së për trajtimin e sigurisë dhe saktësisë së sistemit të informacionit në DK.

Në gjatë fazës para-studimore, pasi që shqyrtuam dokumentet lidhur me sistemet e TI-së dhe proceset doganore dhe intervistave me zyrtarët përgjegjës të DK-së identifikuam mangësitë në vijim:

- DK ka mangësi në organizimin, strukturën dhe politikën e sigurisë së informacionit;
- DK nuk ka adresuar çështjet e sigurisë së informacionit në marrëveshjen për zhvillimin dhe pastaj marrëveshjet e mëvonshme për mirëmbajtje dhe avancim;
- Në sistem ASYCUDA World në DK nuk përdoret qasja e sigurtë me autentikim të shumëfishtë;
- Sistemi ASYCUDA World ka mungesë të ndërlidhjeve me sistemet e tjera, si pasojë disa nga regjistrimet bëhen manualisht si regjistrimi i numrit personal.
- DK edhe pse përdor sistemin INES për regjistrimin e markës tregtare nuk arrin të bëjë identifikimin e markës së mbrojtur, në mungesë të ndërlidhjes së këtij sistemi me sistemet ASYCUDA World dhe LES ECM.

Njëkohësisht ky auditim kryhet në kuadër të Programit LOTA të IDI që ka për qëllim zhvillimin e SAI-ve në auditimet e TI-së, përdorimin e TI-së dhe Strategjinë.

Shqyrtimi i treguesve të problemit të identifikuar nga burime të ndryshme, takimet e mbajtura me personat përgjegjës për identifikimin e çështjeve në sistemet e informacionit në DK, si dhe nga vlerësimet tona të bazuara në Manualin Aktiv të Auditimit të TI-së³² për identifikimin e fushave më me rrezik nga dokumentacioni i pranuar na orienton në problemin kryesor: DK-ja ka mangësi në organizimin e sigurisë së informacionit dhe kontrollin e aplikacionit.

32 Manuali Aktiv i Auditimit- është platformë e zhvilluar nga ITWG/EUROSAT dhe WGITA/INTOSAI, që përdoret për identifikimin e fushave më me rrezik, përcaktimin e pyetjeve, kriterëve dhe metodologjisë së punës gjatë procesit të auditimit të TI-së.

1.1. Përshkrimi i sistemit

1.1.1. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT), në bazë të Rregullores³³ për fushat e përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, ka përgjegjësitë për: Përgatitjen, hartimin, miratimin, zbatimin, vlerësimin dhe mbikëqyrjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e menaxhimit të financave publike, kontrollit të brendshëm dhe auditimit për sektorin publik, standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar për sektorin privat dhe ndërmarrjet publike, borxhit publik, prokurimin publik, politikave makroekonomike dhe fiskale dhe ndihmës shtetërore, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. MFPT ka agjencione për menaxhimin e të hyrave ku në këto agjencione bën pjesë edhe Dogana e Kosovës. Ajo vepron në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Ky bashkëpunim është i strukturuar në disa mënyra kryesore:

1. Mbledhja e të Ardhurave:

Dogana e Kosovës mbledh taksa dhe tarifa doganore nga importet dhe eksportet e mallrave. Këto të ardhura janë një pjesë e rëndësishme e buxhetit shtetëror dhe raportohen tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

2. Zbatimi i Politikave Fiskale:

Dogana është përgjegjëse për zbatimin e politikave fiskale që caktohen nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Kjo përfshin mbledhjen e TVSH-së dhe akcizave për mallrat që hyjnë në Kosovë.

³³ Rregullore (Qrk) - Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

3. Bashkëpunimi në Legjislacion:

Dogana punon së bashku me Ministrinë për të hartuar dhe përmirësuar legjislacionin doganor dhe politikën tregtare. Kjo siguron që politika doganore të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të mbrojë interesat ekonomike të Kosovës.

4. Kontrolli dhe Monitorimi:

Dogana e Kosovës dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve bashkëpunojnë për të siguruar monitorimin dhe kontrollin e saktë të flukseve tregtare dhe financiare. Kjo përfshin luftimin e kontrabandës dhe evazionit fiskal.

5. Teknologjia dhe Trajnimi:

Ka një bashkëpunim të vazhdueshëm në fushën e teknologjisë së informacionit dhe trajnimit të stafit për të përmirësuar efikasitetin e operacioneve doganore dhe financiare.

6. Rishikimi dhe Raportimi:

Dogana e Kosovës rishikon dhe raporton të ardhurat dhe aktivitetet e saj periodikisht tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, duke siguruar transparencë dhe përgjegjshmëri në menaxhimin e fondeve publike.

Këto pika tregojnë lidhjen e ngushtë dhe të domosdoshme mes Doganës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që ka për qëllim optimizimin e administrimit fiskal dhe ekonomik të vendit.

1.1.2. Dogana e Kosovës

Dogana e Kosovës është themeluar në gusht të vitit 1999 nga shtylla e BE-së, për të siguruar aplikimin e drejtë e të njëtrajtshëm konform rregullave doganore dhe dispozitave të tjera të aplikueshme për mallra, të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes doganore. Me 12 dhjetor 2008 Shërbimi Doganor i UNMIK-ut u shndërrua në

Doganën e Kosovës. Kodi doganor, i miratuar me 11 nëntor 2008³⁴ nga Kuvendi i Kosovës i cili mundësoi këtë tranzicion, më vonë në vitin 2012 është ndryshuar dhe plotësuar. Kodi doganor në fjalë është në pajtim të plotë me standardet ligjore të Bashkimit Evropian dhe ndër të tjera ka si objektiv edhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës.

Përpos detyrimeve doganore që vijnë nga Dogana, TVSH-ja dhe Taksa mbi akcizën paguhen në kufij. Përveç vjeljes së të hyrave, Dogana e Kosovës e mbron shoqërinë nga kontrabandimi i drogës dhe mallrave tjera të ndaluara me efekt të dëmshëm të kimit ekonomik si dhe evazionit në të hyra. Dogana Kosovës është zhvilluar në bazë të standardeve të BE-së dhe është i financuar tërësisht nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Po ashtu është e përkrahur nga BE nëpërmjet menaxherëve të lartë profesionalë doganorë, si autoritet ekzekutues të huazuar nga Shërbimet Doganore të BE. Dogana gjithashtu përfiton nga përkrahja teknike e Doganës së BE-së dhe nga Zyra për Asistencë Fiskale (CAFAO), e cila ka ndihmuar në zhvillimin e bazave të legjislacionit, organizimit, strukturës, në trajnimin dhe zhvillimin e stafit. Dogana e Kosovës vlerësohet si një nga institucionet me vlera të larta organizative dhe që nga themelimi ka qenë kontribuese kryesore në aspektin e mbledhjes së të hyrave dhe mbrojtjes së qytetarëve të saj nga mallrat e ndaluara dhe të kufizuara. Të hyrat e mbledhura nga Dogana kontribuojnë rreth 60% të hyrave të gjithmbarshme që grumbullohen për buxhetin e Republikës së Kosovës.³⁵

Dogana e Kosovës në strukturën e rregullores së brendshme ka pesë drejtori si vijon:


- Drejtori i Përgjithshëm;
- Drejtoria Operative dhe Kufiri;
- Drejtoria e Zbatimit të Ligjit;
- Drejtoria e Akcizës dhe Procedurave; si dhe

34 Kodi Nr. 03 L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë.

35 Plani Strategjik i DK-së 2019-2023.

- Drejtoria e Shërbimeve të Përbashkëta. Në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve të Përbashkëta përfshihet Departamenti për Sisteme Doganore dhe Përkrahje të TIK-ut, në të cilin janë përfshirë sektorët e mëposhtëm:
 - Sektori i Sistemeve;
 - Sektori ASYCUDA; si dhe
 - Sektori i Përkrahjes së TIK

Figura 8. Organizimi i drejtorive, departamenteve dhe sektoreve të përfshira në fushë veprim



Drejtoria Operative dhe e Kufirit (DOK) drejtohet nga drejtori i drejtorisë me status doganor, që i përgjigjet drejtpërdrejt DP. Kjo drejtori brenda kompetencave të përcaktuara, koordinon dhe monitoron aktivitetet me departamentet rajonale dhe drejtoritë tjera të Doganës. Është përgjegjës për planifikim, strategji, vendimmarrje, koordinim dhe kontroll të zbatimit të strategjive, si dhe ndërmerr aktivitete për zbatim të legjislacionit doganor, zbatim i të cilit është caktuar për kompetencën e DOK-së. Koordinon aktivitetet me strukturat kombëtare të zbatimit të ligjit, si dhe me autoritetet doganore të vendeve të treta në kuadër të marrëveshjeve në fuqi. Është përgjegjës për zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit dhe procedurave që kanë të bëjnë, procedurat doganore, strategjive kombëtare në bashkëpunim dhe koordinim me drejtori dhe departamente të veçanta, për të mbledhur të hyrat e ligjshme dhe për të mbështetur lehtësimin e tregtisë së ligjshme.

Drejtoria e Zbatimit të Ligjit (DZL) i përgjigjet Drejtorit të Përgjithshëm. Në kuadër të strategjive dhe planeve operacionale të Doganës së Kosovës dhe në përputhje me sundimin e ligjit, DZL është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit aplikimi i të cilit është caktuar për kompetencën e Doganës, duke siguruar koordinim me departamentet tjera sidomos ato rajonale. Është përgjegjës për zbatimin dhe zhvillimin e sistemit kombëtar të menaxhimit të riskut të bazuar në analizën e riskut dhe inteligjencë dhe në koordinim të plotë me njësitë rajonale. Kujdeset dhe mbikqyrë zbatimin e ligjit dhe procedurave që lidhen me mbrojtjen e së Drejtës së Pronësisë Intelektuale (DPI). Koordino aktivitetet me agjencitë e tjera kombëtare të zbatimit të ligjit, si dhe me autoritetet doganore të vendeve të treta në kuadër të marrëveshjeve në fuqi.

Drejtoria e Akcizës dhe Procedurave (DAP) drejtohet nga drejtori i drejtorisë me status doganor, që i përgjigjet drejtpërdrejt DP. Brenda kompetencave të përcaktuara, koordinon dhe monitoron aktivitetet e DAP dhe strukturave vartëse. Është përgjegjës për planifikim, strategji, koordinim, vendimmarrje dhe kontroll të zbatimit të strategjive, si dhe aktiviteteve për zbatimin e legjislacionit doganor, lehtësimit të tregtisë, avancimit të procedurave përkatëse doganore, zbatimi i të cilit është caktuar për kompetencën e DAP-së. Koordinon aktivitetet me drejtoritë tjera, departamentet doganore dhe agjencitë e tjera, si dhe me autoritetet doganore të vendeve të treta në kuadër të marrëveshjeve në fuqi. Është përgjegjës për zhvillimin e sistemeve dhe instituteve brenda drejtorisë dhe përkrahjes në aplikimin e drejtë të tyre nga drejtoritë tjera. Kujdeset për zbatim të legjislacionit doganor në lidhje procedurat, akcizën, rregullat e origjinës, klasifikimit doganor të mallrave dhe tarifës doganore, vlerës doganore, laboratorit të doganës dhe mbikëqyrjes së borxheve.

Drejtoria e Shërbimeve të Përbashkëta (DSHP) drejtohet nga drejtori i drejtorisë me status doganor, që i përgjigjet drejtpërdrejt Drejtorit të Përgjithshëm (DP) brenda kompetencave të përcaktuara, dhe ka detyra dhe përgjegjësi të koordinon dhe monitoron aktivitetet e DSHP dhe strukturave vartëse. Është përgjegjës për planifikim, strategji, koordinim dhe kontroll të zbatimit të strategjive, si dhe ndërmerr aktivitete dhe vendime për zbatim të legjislacionit, zbatimi i të cilit është caktuar për kompetencën e DSHP. Është përgjegjëse për politikat e buxhetit të Doganës dhe për detyrimet që kanë të bëjnë me kontabilitet dhe shpenzime. Kujdeset rreth zhvillimit të politikave dhe strategjive të BNJ dhe zbatimit të legjislacionit përkatës. Përgatit planin vjetor të buxhetit për Doganën dhe njësi organizative të saj. Kujdeset dhe monitoron politikat e prokurimit dhe TI-së, duke

përfshirë inovacionet në sistemet e TI-së dhe ASYCUDA. DSHP përbëhet nga njësi organizative departamente dhe sektorë nën menaxhimin e drejtorit të DSHP-së apo të departamenteve përkatëse, ku bën pjesë edhe Departamenti për Sisteme Doganore dhe Teknologji Informativ (DSD&TIK).

Departamenti i Sistemeve Doganore dhe Teknologjisë Informativ - Ky departament udhëhiqet nga udhëheqësi i departamentit me status doganor dhe i përgjigjet drejtpërdrejt drejtorit të DSHP-së. Ky departament është përgjegjës për përcaktimin e strategjisë dhe planeve të operimit të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit të DK. Ndërmerr veprime dhe koordinon aktivitetet për zbatimin, zhvillimin dhe menaxhimin e sistemeve të TI-së, sigurisë dhe infrastrukturës, si dhe bën koordinimin dhe mbështetjen e njësive organizative të DK në nivel qendror dhe rajonal për përdorimin e sistemeve, mjeteve dhe aseteve të TI-së.

Në kuadër të këtij departamenti bëjnë pjesë këta sektorë:

- Sektori i Sistemeve;
- Sektori ASYCUDA;
- Sektori i Përkrahjes së Teknologjisë Informativ.

Sektori i Sistemeve (SS) udhëhiqet nga udhëheqësi i sektorit me status doganor, që i përgjigjet udhëheqësit të DSD-TIK. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij sektori janë të kontribuon në zbatimin dhe zhvillimin e strategjisë së sistemeve doganore dhe automatizimin e procedurave. Menaxhon dhe administron Sistemet e Zbatimit të Ligjit dhe Menaxhim të Rasteve, Platformën Virtuale “VMware” dhe Auditimin e Sistemeve, Sistemit për Menaxhim të Stafit dhe sistemet tjera në lidhje me paraqitjen elektronike dhe procedurat Doganore. Është përgjegjës për menaxhimin dhe zhvillimin e të gjitha mjeteve dhe aplikimeve të cilat janë të nevojshme për automatizimin e procedurave doganore. Kryen analiza për risitë dhe zhvillimin e sistemeve teknologjike të DK-së. Propozon ndryshime dhe zgjidhje të reja teknike për përmirësimin e funksioneve të sistemeve doganore. Ofron specifikimet teknike dhe dokumentet dhe zgjidhjet e nevojshme për përmirësimin e funksioneve të sistemeve dhe procedurave të kompjuterizuara doganore dhe infrastrukturës së sistemeve Doganore.

Sektori ASYCUDA (SAW) udhëhiqet nga udhëheqësi i sektorit me status doganor, që i përgjigjet udhëheqësit të DSD-TIK. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij sektori

janë të menaxhon dhe administraton zhvillimin e sistemit ASYCUDA World (AW), administrimin dhe zhvillimin e platformës BI – Cognos, Systematic Electronic Exchange of Data (SEED)³⁶ dhe sistemet e tjera të cilat kanë të bëjnë me paraqitjen elektronike dhe procedurat doganore. Siguron mirëmbajtjen e rregullt të sistemeve të kompjuterizuara doganore dhe mirëmbajtjen e aplikacioneve të ndryshme dhe mjetet e nevojshme për të mbështetur punën e zyrave. Kontribuon në zbatimin e projekteve ndër-agjenci dhe bashkëpunimit rajonal të tilla si SEED, etj. Është përgjegjës për të kryer shërbimet e instalimit të bazës së të dhënave për Sistemet Doganore dhe të testimit në lidhje me versionet e reja të sistemit operativ, duke ruajtur dhe ndjekur ndryshimet në legjislacion dhe procedura me qëllim të futjes së tyre në sistem. Bazuar në autorizimet përkatëse dhe raportet e marra nga njësitë organizative, kryen përmirësimet e nevojshme në sistem.

Spektori i Përkrahjes së Teknologjisë Informativë - Spektori i Përkrahjes së Teknologjisë Informativë (SPTIK) udhëhiqet nga udhëheqësi i sektorit me status doganor, që i përgjigjet udhëheqësit të DSD-TIK. Është përgjegjës për zhvillimin e sigurisë së sistemit, infrastrukturës së rrjetit, duke filluar nga shfrytëzuesit e rrjetit të brendshëm, firewall, certifikatat e sigurisë dhe PKI (Public Key Infrastructure), implementimin e funksionimit të vazhdueshëm në punë (business continuity) për infrastrukturë, sisteme dhe siguri të TI-së. Bën organizimin, monitorimin, menaxhimin dhe vlerësimin e performancës së resurseve, aktiviteteve dhe infrastrukturës së TI-së. Zhvillon, administron, mirëmban dhe mbikëqyr zbatimin e politikave, procedurave dhe planeve që kanë të bëjnë me administrimin e sistemit të sigurisë, infrastrukturës, sistemeve server, data-baza, aplikacione dhe qasjen e shfrytëzuesve në sistem. Përcakton dhe implementon planin e rimëkëmbjes (disaster recovery plan), për: infrastrukturën e rrjetës, sistemet server, data-bazat, aplikacionet dhe sigurinë e sistemeve. Garanton funksionimin e duhur të sistemeve dhe pajisjeve server si: Domain Controller, Storage-Data file server, Firewall, Backup dhe sistemet e tjera të TI-së; si dhe sistemet e vëzhgimit me kamera, varësisht nevojave të organizatës, të garantojë freskimet e duhura dhe funksionimin e data-bazave dhe aplikacioneve që kanë të bëjnë me Financat, Burimet Njerëzore, Logjistikën, Prokurimin dhe aplikacionet tjera, për të cilat është përgjegjëse TI-ja, të garantojë përkrahjen teknike të nevojshme për të gjitha zyrat e DK-së, për instalimet, mirëmbajtjen, shfrytëzimin e pajisjeve dhe rrjetës.

36 Shkëmbimi sistematik i të dhënave elektronike.

Fushëveprimi dhe pyetjet e auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi do të jetë Dogana e Kosovës dhe departamentet përkatëse për menaxhimin e TI-së, sistemit ASYCUDA dhe proceseve të doganimit.

Drejtoria e Shërbimeve të Përbashkëta - Departamenti i Sistemeve Doganore dhe Përkrahjes së TIK-ut me sektorët: Sektori i sistemeve; Sektori ASYCUDA dhe Sektori i Përkrahjes së TIK.

Drejtoria Operative e Kufirit me departamentet doganore dhe sektorët duke përfshirë një pikë kufitare tokësore, pikën kufitare ajrore dhe atë detare.

Drejtoria e Zbatimit të Ligjit - Sektori për Risk dhe Monitorim (SRM).

Drejtoria e Akcizës dhe Procedurave (DAP) - Departamenti i Akcizës, Tarifës, Origjinës dhe Procedurave (DATOP) me sektorët: Sektori i Origjinës, Sektori i Tarifës, Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve (SPA), Sektori i Akcizës dhe Sektori i Borxheve.

Fokus i auditimit do të jetë siguria e informacionit dhe kontrollet hyrëse dhe të përpunimit të aplikacionit për sistemet e teknologjisë së informacionit që përdoren për proceset doganore me fokus sistemi ASYCUDA World. Auditimi do të mbulojë periudhën nga viti 2022 deri në vitin 2024.

Pyetjet audituese

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit ne kemi parashtruar pyetjet si në vijim:

1. A i zbaton Dogana e Kosovës politikat e kontraktimit?
2. A ka identifikuar dhe adresuar Dogana e Kosovës kërkesat e sigurisë në procedurat e zhvilluara kontraktuale?
3. A posedon dhe a i zbaton Dogana e Kosovës politikat e sigurisë së informacionit?
4. A ka Dogana e Kosovës një strukturë të qartë të sigurisë së TI?

5. A janë të ndërgjegjshëm punonjësit mbi detyrat dhe përgjegjësitë referuar detyrave dhe përgjegjësive mbi sigurinë, si dhe a ju ofrohen trajnime atyre lidhur me sigurinë e informacionit?
6. A është efektiv dhe i sigurtë procesi për ofrimin dhe anulimin e kontrollit të qasjes ndaj punonjësve dhe kontraktorëve?
7. A ekziston një politikë efektive e vazhdimësisë së biznesit në organizatë?
8. A vendosen të dhëna të sakta dhe nga personeli i autorizuar në bazën e të dhënave dhe në aplikacion?
9. A siguron aplikacioni integritet, vlefshmëri dhe besueshmëri të të dhënave gjatë ciklit të përpunimit të transaksionit?

Kriteret e auditimit³⁷

Kriteret e përdorura në këtë auditim rrjedhin nga Manuali Aktiv i Auditimit të TIsë.³⁸

Standardet ndërkombëtare për sigurinë e informacionit³⁹, si dhe dokumentet e Doganës së Kosovës: Marrëveshja për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit⁴⁰ dhe dokumenti i miratuar për vlerësimin e rrezikut.⁴¹

37 Për më shumë informata konsultoni ISSAI 300, Criteria, p.7

38 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit është produkt i grupeve të punës së teknologjisë së informacionit të EUROSAI-t (WGITA) si dhe Iniciativës për zhvillim të INTOSAI-t (IDI) për përcaktimin e rregullave e standardeve të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.- më tej Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

39 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO/IEC 27000/01.

40 Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë së specializuar të Kombeve të Bashkuara - UNCTAD për Projektin softueri për Dogana, e ratifikuar në Kuvendin e Rep. së Kosovës.

41 Identifikimi i rreziqeve për Doganën e Kosovës 2023.

Për të vlerësuar identifikimin e nevojave dhe adresimin e kërkesave të sigurisë së informacionit në projektet e kontraktuara në Doganën e Kosovës janë vendosur kriteret e mëposhtme:

- Organizata duhet të zbatoj politikat organizative mbi kontraktimin.⁴²

Dogana e Kosovës duhet të zbatoj marrëveshjen e nënshkruar duke përfshirë nenin në vijim: Në fazat fillestare të projektit, aktivitetet përgatitore që do të ndërmerren, duke përfshirë përpjekjet për të siguruar që ndërgjegjësimi dhe mobilizimi të arrijë tek gratë në grupet e ndryshme në fjalë (dogana, tregtarë). Në përputhje me angazhimin e saj për të promovuar barazinë gjinore/ngritjen e ndërgjegjësimit, UNCTAD inkurajon fuqishëm pjesëmarrjen e punonjësve femra në projekte dhe aktivitete trajnimi dhe ngjarje të tjera.⁴³

- Kërkesat e sigurisë së organizatës duhet të jenë të theksuara nga kontraktori në mënyrë të përshtatshme.⁴⁴

Marrëveshja me palët e jashtme që përfshin qasjen, përpunimin, komunikimin ose menaxhimin e informacionit ose strukturës së përpunimit të informacionit të organizatës, ose futjen e produkteve ose shërbimeve në sistemin për përpunimin e informacionit, është në përputhje me të gjitha kërkesat e duhura të sigurisë.⁴⁵

Për të vlerësuar se Dogana e Kosovës ka mekanizma për sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e biznesit janë vendosur kriteret e mëposhtme:

- Dogana e Kosovës duhet të dokumenton, aprovon dhe komunikon politikat dhe procedurat e duhura për të udhëzuar operacionet e biznesit dhe të TI-së, me qëllim të arritjes të mandatit të saj. Politikat e sigurisë së informacionit duhet të mbulojnë të gjitha rreziqet operacionale dhe të kenë mundësi të mbrojnë në mënyrë të arsyeshme të gjithë asetet e informacioneve kritike kundrejt humbjeve, dëmtimit dhe abuzimit. (Ref. ISO 27000: Sistemi i

42 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit - Kontraktimi

43 Shtojca 2 e Marrëveshjes ndërmjet Doganës së Kosovës dhe Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), Mars 2023.

44 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontraktimi, Siguria

45 ISO 27001 – Politikat e Sigurisë së Informacionit.

menaxhimit të sigurisë së informacionit dhe politika të tjera të brendshme, procedura ose rregulla të aplikueshme).⁴⁶

- Dogana e Kosovës duhet të ketë detyra dhe përgjegjësi të qarta të TI-së lidhur me Politikën e Sigurisë së Informacionit, jo konflikte përgjegjësish ose jo-harmoni në aktivitetet e sigurisë së informacionit.(referuar ISO 27000).⁴⁷

Aktivitetet e sigurisë së informacionit duhet të koordinohen nga përfaqësues nga pjesë të ndryshme të organizatës, me role dhe përgjegjësi përkatëse. Duhet të jetë i përcaktuar dhe të zbatohet procesi i autorizimit nga menaxhmenti për sistemet e informacionit ekzistuese dhe ato të reja. Kërkesat për konfidencialitet ose marrëveshje mos-zbulimi që pasqyrojnë nevojat e organizatës për mbrojtjen e informacionit duhet të identifikohen dhe rishikohen rregullisht. Rreziqet për informacionin e organizatës dhe objektet e përpunimit të informacionit nga proceset e biznesit që përfshijnë palë të jashtme duhet të identifikohen dhe kontrollet e duhura duhet të zbatohen përpara se të lejohet qasja. Sistemet e informacionit duhet të jenë të konfiguruar dhe të funksionojnë për të siguruar që gjurmët e auditimit gjenerohen për të gjitha të dhënat e transaksioneve. Raportet e ngjarjeve duhet të jenë të sakta për të gjitha aktivitetet që bëhen nga përdoruesit e sistemit. Qasjet në regjistrat e gjurmëve të auditimit duhet të jenë të kufizuar dhe duhet të kontrollohen, si dhe duhet të sigurohet integriteti i të dhënave të gjurmës së auditimit kundër modifikimit.⁴⁸

- Dogana e Kosovës duhet të sigurohet se të gjithë punonjësit (përfshirë të kontraktuarit ose përdoruesit e të dhënave sensitive) janë të kualifikuar për mirëmbajtjen e të dhënave, përdorimin e burimeve, kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë. Që prej rekrutimit e deri në shkëputjen e marrëdhënieve të punës personeli duhet të ruaj Sigurinë e Informacionit. Sapo të ndërpritet kontrata e punësimit/kontraktimit qasja e tyre ndërpritet.

46 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Informacionit dhe Siguria Kibernetike, Politikën e sigurisë së informacionit.

47 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Informacionit dhe Siguria Kibernetike, Struktura e sigurisë së TI-së.

48 ISO 27001 – Struktura e Sigurisë së TI-së.

Si dhe ju ofrohet trajnim periodik rifreskues. Trajnime, të cilat ofrojnë aftësitë dhe njohuritë e duhura ndaj punonjësve, roli i të cilëve në organizatë është domethënës për Sigurinë e Informacionit dhe Kibernetikës.⁴⁹

- Politikat e qasjes në Doganën e Kosovës duhet të japin një bazë për kontrollin e ndërhyrjes ndaj informacioneve. Funkzioni i sigurisë së informacionit monitoron efektivitetin e kontrollit të operacioneve të menaxhimit të llogarive të përdoruesve në kohë dhe raporton efikasitetin dhe efektivitetin e operimit.⁵⁰

Ndarja dhe përdorimi i privilegjeve në mjedisin e sistemit të informacionit duhet të jetë i kufizuar dhe i kontrolluar, d.m.th., privilegjet ndahen në bazë të nevojës për përdorim, privilegjet ndahen vetëm pas procesit formal të autorizimit.⁵¹

- Dogana e Kosovës duhet të mbulojë të gjitha fushat kritike të organizatës në grup. Kërkesat për detyrat dhe përgjegjësitë për anëtarët e grupit.⁵²

Testet e planit të vazhdimësisë së biznesit duhet të sigurojnë që të gjithë anëtarët e ekipit të rimëkëmbjes dhe stafi tjetër përkatës janë të vetëdijshëm për planet dhe përgjegjësinë e tyre për vazhdimësinë e biznesit dhe sigurinë e informacionit dhe e dinë rolin e tyre kur evokohet plani.⁵³

Për të vlerësuar se në sistemin e informacionit ASYCUDA World ekzistojnë mekanizma kontrollues të aplikacionit të cilët mundësojnë qasjen e sigurt logjike dhe të besueshme në sistemin informativ janë vendosur kriteret e mëposhtme:

- Rregullat e vlefshmërisë duhet të jenë të mirë-hartuara, të dokumentuara dhe të zbatuara në ndërvëprimin e hyrjeve (inputit); duhet të dokumentohen

49 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Informacionit dhe Siguria Kibernetike, Siguria e TI-së e Burimeve Njerëzore.

50 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Informacionit dhe Siguria Kibernetike, Kontrollat e qasjes.

51 ISO 27001 – Kontrollat e Qasjes.

52 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – PVB – PRF - Struktura e Funkcionit të Vazhdimësisë së Biznesit.

53 ISO 27001 – Struktura e funksionit të vazhdimësisë së biznesit.

metoda të ndryshme për futjen e të dhënave; të dhëna jo valide duhet të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni; kriteret e vlefshmërisë përditësohen në mënyrën e duhur dhe të autorizuar; duhet të ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë së kontrolleve thelbësorë të hyrjes; ka kontrolle dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit.⁵⁴

Duhet të ketë kontrolle dokumentare dhe fizike të mallrave që dalin në kanal in e kuq (ekipet e shikimit), si dhe kontrolli dokumentar në kanal in e verdhë. Kontrolli dokumentar bazuar në analizën e rrezikut për lëndët që dalin në kanal in e gjelbër dhe të kaltër. Kontrollt e tjera post dokumentare nga Sektori i Kontrollit Post Dokumentar.

Duhet të bëhet identifikimi i markave tregtare gjatë fazës së zhdoganimit në DUD rubrika 31 e DUD-it, në mënyrë që pas shënimit të markës tregtare sistemi AW të paralajmërojë se a është markë e mbrojtur.⁵⁵

- Aplikacioni duhet të identifikon në mënyrë korrekte gabimet në transaksione. Integriteti i të dhënave duhet të ruhet edhe gjatë ndërprerjeve të rastësishme në përpunimin e transaksioneve. Duhet të ekziston një mekanizëm i përshtatshëm për trajtimin e gabimeve në përpunim, rishikim dhe qartësim të dosjeve në pezullim.⁵⁶

Zyrtarët nga sektori përkatës në kontinuitet duhet të merren me rifreskimin e vlerësimit të rrezikut, pranojnë informata dhe i procesojnë në sistemin ASYCUDA World, të cilat më pas mund të lexohen në formë të kriterëve gjatë fazës së ekzaminimit, si dhe çdo shfrytëzues i AW, po ashtu bazuar në këto kritere (nivele të rrezikut) lëndët ri-kanalizohen nga vetë sistemi AW në kanal in e Verdhe, Kaltër, Gjelbër dhe Kuq.⁵⁷

54 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollt e Aplikacionit, Kontrollt e hyrjes.

55 Dogana e Kosovës – Identifikimi i Rreziqeve për Doganën e Kosovës 2023.

56 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollt e aplikacionit, Kontrollt e përpunimit.

57 Dogana e Kosovës – Identifikimi i Rreziqeve për Doganën e Kosovës 2023.

Metodologjia e auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjeve audituese dhe me qëllim të mbështetjes së konkluzioneve të auditimit do të zbatojmë metodologjinë në vijim:

Për të vlerësuar identifikimin e nevojave dhe adresimin e kërkesave të sigurisë së informacionit në projektet e kontraktuara në Doganën e Kosovës do të realizohen:

- Rishikim i politikave dhe dokumenteve të kontraktimit për tu siguruar nëse janë aprovuar dhe zbatuar.
- Rishikim të dokumenteve për të vlerësuar se organizata ka identifikuar rreziqet dhe është në dijeni lidhur to.
- Rishikim të dokumenteve për të vlerësuar se kërkesat e sigurisë janë identifikuar prej organizatës dhe janë hartuar në kontratë ose në SLA.
- Verifikim nëse organizata ka siguri mbi mekanizmat e sigurisë të vendosura nga ofruesi i shërbimit.

Për të vlerësuar se Dogana e Kosovës ka mekanizma për sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e biznesit do të realizohen:

- Kontrolle të dokumenteve për të verifikuar nëse Strategjia e TI-së adreson në mënyrë të përshtatshme rolin kritik të sigurisë së informacionit. Gjithashtu, referim të përdorimit të matricës së Qeverisjes TI-së dhe matricës së Strategjisë TI-së. Kontrollimi nëse plani i sigurisë së TI-së identifikon: detyrat dhe përgjegjësitë, kërkesat e stafit, ndërgjegjësimi dhe trajnimi mbi sigurinë, zbatimi i praktikave, nevoja për investime në burimet e kërkuara të sigurisë. Rishikimi dhe analizimi i diagramit për të verifikuar se i referohet një apetiti të rrezikut organizativ të lidhur me sigurinë e informacionit dhe se ky diagram përfshin qartazi qëllimin dhe objektivat e funksionit të menaxhimit të sigurisë.
- Përcaktimi nëse janë mirë përcaktuar përgjegjësitë për sigurinë e TI. Kontrollimi nëse ekziston një proces për prioritizimin e iniciativave të propozuara të sigurisë, përfshirë nivelet e kërkuara të politikave, standardeve dhe procedurave.
- Kontrolli nëse rolet që janë kritike për sigurinë e informacionit janë të përcaktuara dhe të dokumentuara qartë. Punonjësit dhe palët e treta

të cilave u janë caktuar role të tilla duhet të dinë përgjegjësitë e tyre në lidhje me mbrojtjen e aseteve të informacionit të organizatës. Rishikimi për përcaktimin e duhur të roleve kritike, për të cilat kërkohen kontrole të verifikimit të sigurisë. Kontrolli për ndarjen e duhur të detyrave ndërmjet menaxhimit të sigurisë së TI-së dhe operacioneve. Kontrolli nëse politika e vendosjes, transferimit dhe rotacionit të personelit të TI-së, si dhe përfundimi i punonjësve është e qartë për të reduktuar varësinë nga individit. Verifikimi se cilët mekanizma të transferimit të njohurive janë ndjekur.

- Kontrolli të procedurave për të përcaktuar sesa shpesh qasjet dhe privilegjet e përdoruesve rishikohen. Kontrolli sesi privilegjet e dhëna ndaj përdoruesve janë konfirmuar.

Intervista me mostër përdoruesish dhe kontrolli të instruksioneve për të verifikuar sesi informohen përdoruesit mbi përgjegjësitë e tyre në mbrojtjen e informacionit sensitiv ose të aseteve, nëse u është dhënë qasje përkatëse.

- Rishikim të dokumenteve/intervistë me stafin përgjegjës për të vlerësuar të gjitha fushat kritike të organizatës të cilat duhet të përfaqësohen në grupin e vazhdimësisë së biznesit. Rishikim të dokumenteve për të vlerësuar se ekzistojnë pronësi dhe detyra mbi përgjegjësitë e vazhdimësisë së biznesit në menaxhmentin e lartë. Për shembull, nëse menaxhmenti ka identifikuar nivelin dhe emergjencën e rimëkëmbjes dhe nëse është reflektuar kjo në politika. Rishikim të dokumenteve për të vlerësuar se të gjithë departamentet kritike kanë përcaktuar anëtarë në grupin për rimëkëmbje nga fatkeqësitë së bashku me detyrat e mirë-përcaktuara. Intervista me një numër të personelit në grupin e vazhdimësisë së biznesit/ ose ekuivalent, për të vlerësuar nëse ata janë të ndërgjegjshëm për rolin e tyre në vazhdimësinë e biznesit për secilën njësi/departament kritik të biznesit.

Për të vlerësuar se në sistemin e informacionit ASYCUDA World ekzistojnë mekanizma kontrollues të aplikacionit të cilët mundësojnë qasjen e sigurt logjike dhe të besueshme në sistemin informativ do të realizohen:

- Kontrolli nëse rregullat e vlefshmërisë janë të mirë hartuara dhe të dokumentuara. Verifikimi nëse kontrollet e vlefshmërisë për të dhënat hyrëse janë në zbatim: observim të përdoruesve të aplikacioneve në veprime reale, ekzekutimi i aplikacionit në mjedis testimi dhe testimi i ndërveprimeve të ndryshme për të dhënat e hyra; analizim të regjistrave të të dhënave

të ruajtura në bazën e të dhënave nëpërmjet përdorimit të CAAT-s (IDEA). Të merret përshkrim funksional për secilën klasë të informacionit të hyrjes dhe dizajnit për regjistrimin e të dhënave të transaksionit. Inspektimi i funksionalitetit dhe modelit për praninë e kontrolleve në kohë, të plotë dhe mesazheve të gabimit.

Vlerësimi nëse kriteret dhe parametrat e vlefshmërisë në të dhënat hyrëse korrespondojnë me rregullat e biznesit dhe zbatojnë refuzimin e llojeve të të dhënave që nuk përshtaten. Inspektimi i menaxherëve mbi rishikimin periodik të kriterëve dhe parametrave të vlefshmërisë së të dhënave hyrëse, nëse ato konfirmohen dhe autorizohen në mënyrën e duhur. Siguria duhet të ruhet nëpërmjet rishikimit të dokumentacionit, analizave të kodimit dhe intervistave. Përcaktimi se cilat ndërveprime ekzistojnë me aplikacionin. Këto ndërveprime duhet të jenë në një formë të transmetimit në kohë reale ose periodike të të dhënave nëpërmjet proceseve të paketave. Rishikimi i diagrameve të rrjedhjes së proceseve dhe të kodit të sistemit.

- Vlerësimi nëse aplikacioni përmban kontrole të sakta të vlefshmërisë për të siguruar integritetin e përpunimit. Inspektimi i barazimeve dhe dokumenteve të tjerë për të verifikuar nëse numërimet e hyrjeve janë koherente me numërimet e daljeve për tu siguruar rreth përpunimit të të dhënave. Përcjellja e transaksioneve nëpërmjet procesit për të verifikuar se barazimi përcakton efektivisht nëse dosjet totale korrespondojnë me kushtet jashtë bilancit të raportuar.

Inspektimi i gjurmëve të auditimit dhe dokumente të tjerë, plane, politika dhe procedura për të verifikuar se kapacitetet e sistemit janë dizenuar efektivisht për të ruajtur automatikisht integritetin e të dhënave. Inspektimi i përshkrimit funksional dhe informacioni i dizajnit për futjen e të dhënave të transaksioneve për të verifikuar nëse transaksionet që nuk funksionojnë në rutinat e vlefshmërisë janë postuar në skedarë të pezullimit. Konfirmimi që transaksionet më të vjetra të dështuara janë korrigjuar siç duhet.

Dokumentet relevante

Rregulloret

Rregullore (Qrk) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive

Kjo rregullore përcakton fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive në Qeverinë e Republikës së Kosovës

Dokumente relevante

Kodi Nr.03 L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë

Ky Kod bën rregullimin e elementeve bazë të sistemit për mbrojtjen doganore të ekonomisë së Republikës së Kosovës dhe të drejtat e obligimet e të gjithë pjesëmarrësve, në zbatimin e legjislacionit doganor.

Plani Strategjik i DK-së 2019-2023

Ky dokument përcakton prioritetet dhe objektivat strategjike si dhe veprimet të cilat Dogana e Kosovës synon t'i ndjekë për periudhën 2019-2023. Përmes kësaj strategjie, synohet që me përdorim sa më racional të burimeve në dispozicion të zbatohen politikat dhe të zhvillohen procedurat që lidhen me zinxhirin e tregtisë ndërkombëtare, qarkullimin e mjeteve dhe udhëtareve si dhe kontrollin doganor në kufi dhe në brendi.

Shtojca 2: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANORJEVE / DATUM PRANORJEVA DITË / DAY			
17-2024			
Njësia Org. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Fjalëve Br. Stranica No. Pages
06	47	22557	1



13.12.2024 DALJE NË SHKËRIM

Nr. Prot. 01/1029/2024

Ministri / Ministar / Application / ...

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs
Zyra e drejtorit të përgjithshëm
LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit 'Sistemet e Informacionit në Doganën e Kosovës - ASYCUDA World', dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë
19 Dhjetor 2024

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:


- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **Sistemet e Informacionit në Doganën e Kosovës - ASYCUDA World** (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Agron Llugaj
Drejtori i Përgjithshëm
Dogana e Kosovës



Prishtinë

19 Dhjetor 2024



Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës